



PARIMET PËR ETIKËN PROFESSIONALE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR (Rishikuar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5259 Prot.

Tiranë, më 26.08. 2025

URDHËR

Nr. 412, datë 26.08. 2025

PËR

MIRATIMIN E “PARIMEVE TË ETIKËS PROFESIONALE TË SHËRBIMIT
PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR (RISHIKUAR)”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “d” të pikës 5 të vendimit nr.98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP) dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Parimeve të etikës profesionale të shërbimit psiko-social shkollor (rishikuar)”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. “Parimet e etikës profesionale të shërbimit psiko-social shkollor”, miratuar në qershor 2022, shfuqizohen.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-social Shkollor” u hartua nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Hartimi i dokumentit u koordinua nga:

Esion Zgjana

Përgatitja e dokumentit:

Esion Zgjana

Rezarta Pullazi

Orsjola Miha

Anisa Asllanaj

Ornela Belba

Jona Hila

Redaktimi letrar:

Zija Kurti

Redaktimi shkencor:

Esion Zgjana

Olta Jaçellari

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	2
TERMA	6
PARATHËNIE	8
PËRCAKTIMI I TERMAVE TË PËRDORUR NË PARIMET PËR ETIKËN PROFESIONALE.....	10
PËRDORIMI I PARIMEVE TË ETIKËS PROFESIONALE.....	12
FUSHA I: RESPEKTIMI I DINJITETIT DHE TË DREJTAVETË ÇDO INDIVIDI	15
Parimi i përgjithshëm I.1 Autonomia dhe vetëvendosja	15
Standardi I.1.1 Kur miratimi/pëlqimi kërkohet/nuk kërkohet	15
Standardi I.1.2 Miratimi/pëlqimi për krijimin e një marrëdhënieje punonjës i shërbimit psiko-social-nxënës	16
Standardi I.1.3 Kërkimi i miratimit/pëlqimit të informuar	17
Standardi I.1.4 Aprovimi	17
Standardi I.1.5 E drejta për të refuzuar ose për të térhequr miratimin/pëlqimin	18
Parimi i përgjithshëm I.2 Privatësia dhe konfidencialiteti	18
Standardi I.2.1 Informacion lidhur me privatësinë	18
Standardi I.2.2 Limitet e konfidencialitetit	19
Standardi I.2.3 Miratimi/pëlqimi për zbulimin e informacionit.....	19
Standardi I.2.4 Nevoja për të ditur/orientim profesional	20
Standardi I.2.5 Privatësia lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor	20
Standardi I.2.6 Privatësia e informacionit shëndetësor	20
Parimi i përgjithshëm I.3 Komunikimi	21
Standardi I.3.1 Respekti dhe dinjiteti	21
Standardi I.3.2 Komunikimi i qartë dhe i kuptueshëm.....	21
Standardi I.3.3 Dëgjimi aktiv dhe empatia	21
Standardi I.3.4 Qetësia dhe vetëkontrolli	22
Standardi I.3.5 Bashkëpunimi	22
Parimi i përgjithshëm I.4 Paanshmëria, drejtësia dhe barazia.....	22

PARIMET PËR ETIKËN PROFESIONALE TË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

Standardi I.4.1 Diskriminimi	23
Standardi I.4.2 Korrigjimi i praktikave diskriminuese	23
FUSHA II: KOMPETENCA DHE PËRGJEGJËSIA PROFESIONALE.....	24
Parimi i përgjithshëm II.1 Kompetenca	24
Standardi II.1.1 Praktika në fushën e kompetencës.....	24
Standardi II.1.2 Respektimi i orarit zyrtar të punës	25
Standardi II.1.3 Kodi i veshjes.....	25
Standardi II.1.4 Problemet personale	27
Standardi II.1.5 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional	27
Parimi i përgjithshëm II.2 Pranimi i përgjegjësisë për veprimet.....	27
Standardi II.2.1 Saktësia e dokumenteve.....	27
Standardi II.2.2 Monitorimi i progresit	28
Standardi II.2.3 Përshtatshmëria e rekomandimeve.....	28
Standardi II.2.4 Përgjegjësia për punën e studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale	28
Parimi i përgjithshëm II.3 Vlerësimet e përgjegjshme dhe praktikat e ndërhyrjes	29
Standardi II.3.1 Konsiderata para përcaktimit të aftësisë së kufizuar	29
Standardi II.3.2 Teknikat e vlerësimit	29
Standardi II.3.3 Përzgjedhja e instrumenteve	29
Standardi II.3.4 Të dhënat normative	30
Standardi II.3.5 Administrimi dhe vlerësimi digital	30
Standardi II.3.6 Shumëllojshmëria e burimeve të të dhënave	30
Standardi II.3.7 Vlerësimi gjithëpërfshirës.....	30
Standardi II.3.8 Vlefshmëria dhe drejtësia	30
Standardi II.3.9 Përkthyesit.....	31
Standardi II.3.10 Interpretimi i rezultateve	31
Standardi II.3.11 Përzgjedhja e ndërhyrjes	31
Standardi II.3.12 Përfshirja e prindërve në planifikimin e ndërhyrjes	31
Standardi II.3.13 Aprovimi i nxënësit për ndihmë.....	32
Parimi i përgjithshëm II.4 Mbajtja e përgjegjshme e regjistrat të të dhënave.....	32
Standardi II.4.1 Njoftimi i të drejtave dhe i përgjegjësive në lidhje me regjistrin e të dhënave	32
Standardi II.4.2 Registri i të dhënave gjithëpërfshirëse.....	32
Standardi II.4.3 Përbajtja e regjistrat të të dhënave të nxënësit.....	33
Standardi II.4.4 E drejta për të inspektuar regjistrat.....	33
Standardi II.4.5 Protokollet e testeve	33

PARIMET PËR ETIKËN PROFESIONALE TË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

Standardi II.4.6 Qasja në regjistrime nga burimet njerëzore të shkollës	33
Standardi II.4.7 Mbajtja e regjistrimeve elektronike	34
Standardi II.4.8 Regjistrimet e pronësisë ekskluzive	34
Standardi II.4.9 Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave	34
Parimi i përgjithshëm II.5 Përdorimi i përgjegjshëm i materialeve burimore.....	35
Standardi II.5.1 Siguria e testeve	35
Standardi II.5.2 Përdorimi i materialeve të kufizuara	35
Standardi II.5.3 Pronësia intelektuale.....	36
FUSHA III: NDERSHMËRIA DHE INTEGRITETI NË MARRËDHËNIET PROFESIONALE.....	37
Parimi i përgjithshëm III.1 Përfaqësim i saktë	37
Standardi III.1.1 Prezantimi i saktë i kualifikimeve profesionale.....	37
Standardi III.1.2 Korrigimi i perceptimeve të gabuara.....	37
Standardi III.1.3 Anëtarësimi dhe përvoja.....	38
Parimi i përgjithshëm III.2 Shpjegimi i drejtë i shërbimeve, i roleve dhe i përparësive profesionale	38
Standardi III.2.1 Shpjegimi i shërbimeve për nxënësit	38
Standardi III.2.2 Prioriteti mirëqenia e fëmijës.....	38
Standardi III.2.3 Papajtueshmëria	38
Parimi i përgjithshëm III.3 Respektimi i profesionistëve të tjerë	39
Standardi III.3.1 Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë	39
Standardi III.3.2 Referimet te profesionistët e tjerë	39
Standardi III.3.3 Ndryshimi i raporteve.....	40
Parimi i përgjithshëm III.4 Integriteti në marrëdhënie	40
Standardi III.4.1 Marrëdhëni e shumëfishta dhe efektiviteti profesional	40
Standardi III.4.2 Marrëdhëni e shumëfishta dhe shërbimet alternative të limituara	40
Standardi III.4.3 Ngacmimi dhe shfrytëzimi	41
Standardi III.4.4 Marrëdhëniet seksuale	41
Parimi i përgjithshëm III.5 Konflikti i interesit	41
Standard III.5.1 Sjellja private kundrejt sjelljes profesionale	42
Standardi III.5.2 Ndarja e besimeve personale	42
Standardi III.5.3 Besimet dhe përvojat personale	42
Standardi III.5.4 Referimet dhe shpërblimi	42
Standardi III.5.5 Shpërblimi për ndarjen e të dhënave	42
Standardi III.5.6 Ushtrimi i detyrës në shkollë kundrejt punës private.....	43

PARIMET PËR ETIKËN PROFESSIONALE TË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

FUSHA IV: PËRGJEGJËSI NDAJ SHKOLLAVE, FAMILJES, KOMUNITETIT, PROFESIONIT DHE SHOQËRISË	44
Parimi i përgjithshëm IV.1 Promovimi i mjesdit të shëndetshëm të shkollës, të familjes dhe të komunitetit	44
Standardi IV.1.1 Pjesëmarrja efektive në sistem	45
Standardi IV.1.2 Promovimi i ndryshimit të sistemeve.....	45
Parimi i përgjithshëm IV.2 Respektimi i ligjit dhe marrëdhënia e ligjit me etikën	45
Standardi IV.2.1 Kuptimi i sistemeve të punës.....	45
Standardi IV.2.2 Kryqëzimi i së drejtës dhe i etikës	46
Standardi IV.2.3 Konfliktet midis ligjit dhe parimeve etike.....	46
Standardi IV.2.4 Pjesëmarrja në fjalimet publike	46
Parimi i përgjithshëm IV.3 Ruajtja e besimit publik përmes vetëmonitorimit dhe monitorimit nga kolegët	46
Standardi IV.3.1 Zbatimi i parimeve	47
Standardi IV.3.2 Zgjidhja e shqetësimeve me kolegët	47
Parimi i përgjithshëmIV.4 Kontributi në profesion duke mentoruar, duke mësuar dhe duke supervizuar	47
Standardi IV.4.1 Supervizimi i studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale	48
Standardi IV.4.2 Përgjegjësia e supervizorit.....	48
Parimi i përgjithshëm IV.5 Kontributi në bazën e njohurive të psikologjisë shkollore/punës sociale.....	48
Standardi IV.5.1 Kryerja e kërkimeve.....	49
Standardi IV.5.2 Mbrojtja e të drejtave të pjesëmarrësve në kërkime	49
Standardi IV.5.3 Anonimiteti i të dhënave	49
Standardi IV.5.4 Saktësia e të dhënave	49
Standardi IV.5.5 Përsëritja e të dhënave.....	50
Standardi IV.5.6 Korrigimi i gabimeve	50
Standardi IV.5.7 Integriteti i publikimeve	50
Standardi IV.5.8 Plagjiatura.....	50
Standardi IV.5.9 E drejta e autorit.....	50
Standardi IV.5.10 Rishikimi i dorëshkrimeve dhe i propozimeve	51
BIBLIOGRAFIA	52
SHTOJCA	53
(Shtojca 1)	54
(Shtojca 2)	55
(Shtojca 3)	56

TERMA

Barazia siguron që të gjithë nxënësit të kenë akses të njëjtë në mundësitë e përgjithshme dhe të veçanta arsimore.

Paanshmëria/drejtësia siguron, që secili nxënës, të marrë atë që i nevojitet për të përfituar nga këto mundësi.

Raca i ka rrënjet në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie, sipas tipareve morfologjike, si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës. Ndalimi i diskriminimit, në bazë të origjinës racore ose etnike, mund të mbulojë gjithash tu, diskriminimin bazuar në ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare. Ky shkak lidhet shpesh, edhe me shkakun tjetër të parashikuar që është ai i ngjyrës. Në Shqipëri, diskriminimi për shkak të racës është lidhur kryesisht, me komunitetet rome dhe egjiptiane.

Përkatësia etnike është e lidhur me një popull a me një komb të caktuar ose me grupe shoqërore, të shënuara nga kombësi apo shtetësi e përbashkët, lidhje fisnore, besim fetar, gjuhë e përbashkët ose prejardhje kulturore dhe tradicionale. Për shkak të këtyre rrethanave personale, individë dhe grupe individësh mund të përballen me diskriminim, si në sferën private, ashtu edhe atë publike, në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Bindja fetare mbalon shprehjen e besimit fetar ose besimin e zgjedhur nga individi, përfshirë edhe mosshprehjen e besimit, që mund të manifestohet privatisht ose publikisht, në vende kulti, në rite dhe në mësime fetare.

Paaftësia: Paaftësia e individit që provohet me raport mjeko-ligjor.

Origjina kombëtare: Kombësia.

Gjuha parësore: Gjuha etnike, gjuha e nënës.

Statusi i refugjatit/emigrimit përfshin fëmijë ose nxënës të shkollës, të cilët kanë lindur dhe/ose janë kthyer nga shtete të tjera, zona të konfliktit, ose janë në procedura për kërkim azili.

Statusi ekonomik kryesisht, lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, që janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze, dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës, në pamundësi shoqërore, arsimore, intelektuale, materiale, kulturore deri dhe ekzistenciale.

Gjinia: Term që përdoret për të përshkruar rolet e ndërtuara në shoqëri për gratë dhe për burrat. Gjinia është identitet i fituar që mësohet, që ndryshon mekalimin e kohës dhe ndryshon shumë, brenda dhe midis kulturave.

Orientimi seksual nënkupton një tërheqje të vazhdueshme, emocionale dhe seksuale, ndaj personave të një seksi të caktuar. Sipas orientimit seksual, ekzistojnë personat të cilët i tërheq seksi i kundërt (personat heteroseksual), personat të cilët i tërheq seksi i njëjtë (personat homoseksual), si dhe personat të cilët i tërheqin të dy sekset (personat biseksual). Krahas këtyre orientimeve, ekzistojnë edhe personat transeksual, interseksual dhe aseksual. Për të gjithë këta persona përdoret shkurtesa e pranuar ndërkombëtarisht LGBTIQ.

Identiteti gjinor lidhet me përvojën individuale të brendshme, të ndjerë të një personi, në lidhje me gjininë, e cila mund të korrespondojë ose jo, me gjininë e caktuar me lindjen e tij, duke përfshirë ndjenjën personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes ose funksionit trupor me anë të mjeteve mjekësore, kirurgjike ose mjeteve të tjera) dhe shprehje të tjera të gjinisë, duke përfshirë veshjen, të folurën dhe sjelljen.

PARATHËNIE

Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollar” është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe aspekteve të rëndësishme psiko-sociale, duke marrë parasysh objektivat strategjikë të edukimit, me një vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.

Hartimi i këtij dokumenti është mbështetur tërësisht, në praktikat më të mira ndërkombëtare, duke pasur parasysh edhe historikun e zhvillimit të strukturës së shërbimit psiko-social në arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument, përsa i përket përbajtjes dhe strukturës së tij, është në të njëjtën linjë me dokumentet e hartuara nga Shoqata Kombëtare e Psikologjisë Shkolllore në SHBA (NASP), si një nga shoqatat më prestigjioze në fushën e mirëqenies së nxënësve në mjediset e institucioneve arsimore.

Modeli i ndjekur për hartimin e këtij dokumenti, është mbështetur në dokumente të cilat përfshijnë vetëm shërbimet e ofruara nga psikologët e shkollave, por duke pasur parasysh strukturën dhe funksionimin e shërbimit psiko-social shkollar në arsimin parauniversitar. Pamundësia e mbulimit me të dy pozicionet (psikolog shkollar dhe punonjës social) të një numri të lartë shkollash, lind nevojën që ky dokument të fokusohet në praktikën e punës në tërsi, të strukturës së shërbimit psiko-social në shkollë.

Në shkollat ku shërbimi psiko-social mbulohet nga të dy pozicionet e punës (psikolog shkollar dhe punonjës social), realizmi dhe përbushja e parimeve etike bëhet, bazuar në kompetencat profesionale dhe në formimin akademik të profesionit përkatës. Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollar” sqaron sjelljen e duhur profesionale të një psikologu shkollar/punonjësi social.

Kontekstualizimi i praktikave ndërkombëtare ka qenë proces që ka marrë vëmendje të rëndësishme, bazuar në aktet ligjore në fuqi, mbi funksionimin e shërbimit psiko-social,

profesionet e rregulluara, mbrojtjen e të dhënave personale, burimet njerëzore në dispozicion, strukturën e institucioneve arsimore, strukturën e njësisë së shërbimit psiko-social etj.

Procesi i planifikimit të hartimit të “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor”, filloi zyrtarisht në vitin 2021. Procesi i hartimit kaloi në disa faza kryesore, ku faza e parë ishte hulumtimi i praktikave ndërkombëtare mbi funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore. Pasi u përzgjodh literatura më bashkëkohore, duke marrë në konsideratë dhe institucionet të cilat kanë publikuar këto materiale burimore, u realizua përkthimi i materialeve nga ekspertë të fushës, duke pasur në vëmendje përshtatjen e terminologjisë së përdorur dhe konsultimin me grupe interesit.

Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor janë zhvilluar për të adresuar rrethanat unike që lidhen me ofrimin e shërbimeve psiko-sociale të shkollës. Detyrën për të edukuar nxënësit dhe autoritetin ligjor për ta bërë këtë, e kanë strukturat shtetërore përgjegjëse për arsimin. Si aktorë brenda strukturave arsimore parauniversitare, punonjësit e shërbimit psiko-social në shkollë, kanë detyrime të veçanta ndaj të gjithë nxënësve. Ata duhet të njojin dhe të respektojnë të drejtat e nxënësve, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar. Ata duhet të balancojnë autoritetin e prindërve për të marrë vendime përfmijët e tyre, me nevojat dhe të drejtat e atyre fëmijëve, me misionin dhe me vizionin e shkollave. Për më tepër, si punonjës të shkollës, punonjësit e shërbimit psiko-social kanë detyrim ligjor dhe etik, për të ndërmarrë hapa për mbrojtjen e të gjithë nxënësve nga fenomenet të cilat mund të çojnë në dëmtimin e mirëqenies psiko-emocionale. Së fundmi, punonjësit e shërbimit psiko-social punojnë në një kontekst që thekson zgjidhjen dhe ndërhyrjen multidisiplinare të problemeve. Sidoqoftë, brenda këtij kuadri, pritet që punonjësit e shërbimit psiko-social të bëjnë zgjedhje etike të kujdeshshme, të arsyetuara dhe parimore, bazuar në njoturinë e këtij dokumenti, duke pranuar se përgjegjësia për sjelljen etike është individuale.

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të përkushtuar në zbatimin e ekspertizës së tyre profesionale, me qëllim nxitjen për përmirësimin e cilësisë së jetës për nxënësit, për familjet dhe për komunitetet shkollore. Ky objektiv zbatohet në mënyra që mbrojnë dinjitetin dhe të drejtat e nxënësít, të familjes dhe të komuniteteve shkollore. Punonjësit e shërbimit psiko-social i konsiderojnë interesat dhe të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, si përparësinë e tyre më të lartë në vendimmarje, dhe veprojnë si mbrojtës dhe mbështetës për të gjithë nxënësit. Supozimet në lidhje me fenomene te ndryshme sociale, kërkojnë që punonjësit e shërbimit psiko-social të flasin për nevojat dhe për të drejtat e nxënësve, edhe kur mund të jetë e vështirë për ta bërë këtë.

PËRCAKTIMI I TERMAVE TË PËRDORUR NË PARIMET PËR ETIKËN PROFESSIONALE

Punonjës i shërbimit psiko-social: Punonjës i shërbimit psiko-social është psikologu ose punonjësi social, i cili ushtron profesionin e tij në mjediset arsimore.

Përfituesi i shërbimit: Përfitues i shërbimit është çdo person me të cilin punonjësi i shërbimit psiko-social krijon marrëdhënje profesionale, me qëllim ofrimin e shërbimeve psiko-sociale shkollore. Marrëdhënia profesionale mes punonjësit psiko-social dhe përfituesit të shërbimeve të shkollës, krijohet me një marrëveshje që i informon ata, në lidhje me detyrat etike dhe me detyra të tjera ndaj se cilës palë. Klasat, shkollat, sistemet shkollore, familjet dhe komunititet nuk janë klientë në vetvete, por mund të janë përfitues të shërbimeve psiko-sociale të shkollës dhe shpesh, janë palë me interes në veprimet e punonjësve të shërbimit psiko-social.

Fëmija: Në ligj, termi “fëmijë”, në përgjithësi, i referohet një të mituri, një personi më të ri se mosha madhore. *Fëmija* përdoret në këtë dokument, për të treguar statusin e mitur ose marrëdhënien prind-fëmijë. Termi “nxënës” i referohet një fëmije, të riu ose të rrituri, të regjistruar në një mjedis arsimor.

Miratimi/pëlqimi i informuar: Miratimi/pëlqimi i informuar nënkupton se personi që jep miratimin/pëlqimin, ka autoritetin ligjor për të marrë një vendim miratimi/pëlqimi dhe një kuptim të quartë të asaj për të cilën po pajtohet, dhe se pëlqimi i tyre jebet lirshëm dhe mund të tërhiqet pa paragjykime.

Aprovimi: Termi “aprovim” i referohet marrëveshjes aprovuese të një të mituri, për të marrë pjesë në shërbime ose kërkime psiko-sociale.

Prindi: Termi “prind” mund të përkufizohet në ligj dhe mund të përfshijë prindin biologjik, prindin birësues, një individ që vepron në vend të një prindi biologjik ose birësues (gjyshi ose

i afërmi, njerku ose partneri në familje), dhe/ose të një individi që ushtron ligjërisht përgjegjësinë prindërore dhe është përgjegjës për mirëqenien e fëmijës (kujdestari ligjor).

Advokimi: Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë një detyrim të veçantë, për të folur për të drejtat dhe mirëqenien e nxënësve dhe të familjeve, për të siguruar një zë për nxënësit që nuk mund ose nuk duan të flasin për veten e tyre. Advokimi gjithashtu, ndodh kur punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin ekspertizën e tyre në psikologji/punë sociale dhe edukim, për të promovuar ndryshimet në shkolla, në sisteme dhe në ligje, ku përfituesit do të jenë nxënësit, shkollat, familja dhe komuniteti. Duke konsideruar rëndësinë e këtij dokumenti, nuk duhet të interpretohet se zbatimi i këtyre parimeve kërkon që punonjësit e shërbimit psiko-social, të angazhohen në mosbindje, e përcaktuar si shpërfillje e qëllimshme të udhëzimeve të ligjshme të punëdhënësit.

Ushtrimi i detyrës në shkollë kundrejt punës private: Për qëllimet e këtij dokumenti, “ushtimi i detyrës në shkollë” i referohet ofrimit të shërbimeve psiko-sociale të shkollës, nën autoritetin e një agjencie arsimore shtetërore, rajonale ose lokale. Ushtrimi i detyrës në shkollë ndodh, kur punonjësi i shërbimit psiko-social është punonjës i shkollës dhe përmbush detyrat funksionale në atë shkollë. “Puna private” ndodh, kur një punonjës i shërbimit psiko-social hyn në një marrëveshje me një klient, jashtë orarit zyrtar të punës dhe jo në një institucion arsimor, për të ofruar shërbime psiko-sociale dhe sociale, dhe kur pagesa për shërbimet është përgjegjësi e klientit ose përfaqësuesit të tyre.

PËRDORIMI I PARIMEVE TË ETIKËS PROFESIONALE

“Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor”, si të gjitha dokumentet që normojnë etikën, parashikon vetëm udhëzime të kufizuara për vendimmarrje dhe zgjedhje etike. Gjykimi individual është i nevojshëm për të zbatuar këto parime, në situatat që lindin gjatë përbushjes së detyrave funksionale. Dilemat etike mund të krijohen nga situata që përfshijnë parime etike konkurruese, nga konflikte midis etikës dhe ligjit, si dhe interesave konfliktuale të palëve të shumta dhe të roleve të dyfishta. Situata të tilla shpesh, janë të ndërlikuara dhe mund të kërkojnë zbatim të pjesshëm të këtyre parimeve, për të ndikuar në një zgjidhje që rezulton në përfitimin më të madh për nxënësin dhe për palët e tjera të përfshira. Kur lindin situata të vështira, punonjësit e shërbimit psiko-social këshillohen të përdorin një proces sistematik të zgjidhjes së problemeve, për të identifikuar rrugën më të mirë të veprimit. Ky proces duhet të përfshijë identifikimin e çështjeve etike, konsultimin e këtyre parimeve, konsultimin e kolegëve me më shumë eksperiencë, vlerësimin e të drejtave dhe të mirëqenies së të gjitha palëve të prekura, marrjen parasysh të zgjidhjeve alternative dhe të pasojave të tyre, si dhe pranimin e përgjegjësisë për vendimet e marra.

Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor mund të kërkojnë një standard më të rreptë të sjelljes sesa ligji, edhe në ato situata në të cilat zbatohen të dyja, punonjësit e shërbimit psiko-social pritet t’iu përbahen këtyre parimeve. Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë kërkesa më gjithëpërfshirëse, etike, kur punojnë me prindërit. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë etikisht të detyruar të sigurojnë, që prindërit të kuptojnë të drejtat e tyre ligjore; të kuptojnë se çfarë po miratojnë ose refuzojnë, të japid miratimin/pëlqimin për të dhe të kuptojnë implikimet e atij vendimi. Për më tepër, punonjësve të shërbimit psiko-social u kërkohen nga ana etike, të sigurohen që prindërvë t’u jepet mundësia, të marrin pjesë në vendimet e rëndësishme që prekin fëmijën e tyre.

Kur ndodhin konflikte midis etikës dhe ligjit, punonjësit e shërbimit psiko-social pritet të marrin hapa për të zgjidhur konfliktet, në një proces të zgjidhjes së problemeve me të tjerët dhe

përmes kanaleve pozitive, të respektuara dhe ligjore. Nëse ata nuk janë në gjendje ta zgjidhin konfliktin në këtë mënyrë, ata mund t'i binden ligjit, përderisa veprimet që rezultojnë, nuk shkelin të drejtat themelore të njeriut. Nëse ligji ose politika kombëtare paraqet pengesë për praktikën etike, punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të mbrojnë ndryshimet në ato ligje, në ato politika dhe në ato praktika, për t'i harmonizuar më mirë me standartet etike.

Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” ofron standarde për sjelljen profesionale. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në jetën e tyre private, janë të lirë të ndjekin interesat e tyre personale, përvèç rasteve kur ato interesa komprometojnë besimin në profesion ose efektivitetin profesional. Kufiri midis sjelljeve profesionale dhe atyre personale nuk është i qartë, veçanërisht në vende, të tilla si mediat sociale. Për më tepër, profesionistët e shkollave ruajnë një standard më të lartë të karakterit dhe të sjelljes së mirë, në raport me të tjerët, sepse shërbejnë si modele përfmijët. Për këto arsy, punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajohen të shmangin veprimet që nuk respektojnë dinjitetin e të tjerëve, që mund të ndikojnë negativisht në besueshmërinë e tyre dhe që pakësojnë besimin në profesion.

Parimet në këtë dokument, duhet të merren parasysh nga punonjësit e shërbimit psiko-social në vendimarrjen e tyre etike, pavarësisht rolit të tyre dhe mjedisit të punës. Sidoqoftë, ky dokument fokusohet në sfidat e veçanta, që lidhen me ofrimin e shërbimeve psiko-sociale brenda shkollës dhe nxënësve.

Katër fusha të gjera etike ofrojnë kuadrin organizativ të “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor”. Secila prej katër fushave të gjera është aspiruese dhe identifikon parimet themelore, që qëndrojnë në themel të praktikës etike të shërbimit psiko-social shkollor. Çdo fushë etike përfshin parimet udhëzuese që shpjegojnë mënyrat në të cilat parimet e gjera etike zbatohen, gjatë përbushjes së detyrave funksionale. Parimet udhëzuese duhet të merren parasysh në vendimarrjen etike. Sidoqoftë, për shkak se qëllimi i tyre është të identifikojnë konsideratat etike, të lidhura me situatat e praktikës, parimet udhëzuese janë aspiruese të zbatueshme. Parimet udhëzuese artikulohen më tej, nga standarde të shumta, të veçanta dhe të zbatueshme të sjelljes. Sa më shumë të jetë e mundur, standartet e zbatueshme identifikojnë veprimet (pamundësinë/dështimet përfshirë), që profesioni i konsideron sjellje etike ose joetike.

Ky dokument kërkon të zbatojë standartet etike për sjellje të veçanta profesionale, në përputhje më aktet ligjore dhe nënligjore të urdhërave përkatëse të profesionit, ku janë të përfshirë

PARIMET PËR ETIKËN PROFESSIONALE TË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

punonjësit e shërbimit psiko-social. Pavarësisht pozicionit të punës, mjedisit të punës, grupmoshës së nxënësve etj., punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të reflektojnë mbi temën dhe synimin e secilit parim dhe standardi etik, për të përcaktuar zbatimin e tyre në situata individuale.

Vendimet e punonjësve të shërbimit psiko-social, përfshirë veprimin ose mosveprimin, ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve dhe të familjeve. Në rolet e tyre profesionale, punonjësit e shërbimit psiko-social kanë për detyrë, jo vetëm të shmangin shkeljet e etikës, por edhe të ndërmarrin hapa vendimtarë, që nga respektimi i parimeve etike të përfitojnë nxënësit, shkollat, familjet dhe komuniteti. Për këtë arsy, punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajohen të përpiken për përsosmëri, sesa thjesht të përbushin detyrimet minimale të përcaktuara në “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor”, dhe të angazhohen në të mësuarit gjatë gjithë jetës, që është i nevojshëm për të arritur dhe për të ruajtur ekspertizën në etikën profesionale të aplikuar.

FUSHA I: RESPEKTIMI I DINJITETIT DHE TË DREJTAVETË ÇDO INDIVIDI

Punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen vetëm në praktika profesionale që ruajnë dinjitetin e të gjithëve me të cilët ata punojnë. Në fjalët dhe veprimet e tyre, punonjësit e shërbimit psiko-social demonstrojnë respekt për autonominë e personave dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, respekt për privatësinë dhe angazhim për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë personat.

Parimi i përgjithshëm I.1 Autonomia dhe vetëvendosja

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtën e personave, për të marrë pjesë në vendimet që ndikojnë në mirëqenien e tyre (shihni *miratimin/pëlqimin e informuar* në përkufizimin e termave). Ata e pranojnë që pëlqimi i informuar është proces i vazhdueshëm, dhe rihapin diskutimin e miratimit/pëlqimit, kur është e përshtatshme, si p.sh., në raste të tillë, kur ka një ndryshim të rëndësishëm në qëllimet dhe shërbimet e dakordësuara më parë, ose kur vendimi merr parasysh dhe ndarjen e informacionit të ndjeshëm me të tjërët.

Standardi I.1.1 Kur miratimi/pëlqimi kërcohët/nuk kërcohët

Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e prindërve/kujdestarëve ligjor në vendimet e shkollës, që prekin fëmijët e tyre. Sidoqoftë, kur punonjësit e shërbimit psiko-social janë anëtarë të stafit arsimor të shkollës, jo të gjitha shërbimet e tyre kërkojnë miratimin/pëlqimin e informuar të prindërve. Etikisht është e lejueshme, që të ofrohen shërbime konsultimi në shkollë, në lidhje me një fëmijë ose adolescent, me një grup nxënësish, pa miratimin/pëlqimin e informuar të prindërve, për aq

kohë sa rezultatet janë nën autoritetin e mësuesit dhe brenda fushës së ndërhyrjeve tipike në klasë. Miratimi/pëlqimi i prindërve nuk kërkohet nga ana etike, që një punonjës i shërbimit psiko-social të rishikojë të dhënat arsimore të një nxënësi, të kryejë vëzhgime në klasë, të ndihmojë në ndërhyrjet brenda klasës dhe të monitorojë progresin (me instrumente të përshtatshme, si: anketime, pyetësor, fokus-grupe, takime individuale me nxënësin) ose të marrë pjesë në shfaqjet arsimore të kryera si pjesë e një programi të rregullt mësimor. Informimi i prindërve nevojitet nëse këshillimi ose shërbimi për një fëmijë/grup fëmijësh ose adoleshent/grup adoleshentësh të caktuar, ka të ngjarë të jetë i gjërë dhe i vazhdueshëm dhe/ose veprimet e shkollës mund të rezultojnë si ndërhyrje e rëndësishme në privatësinë e nxënësve ose familjes, përtrej asaj që mund të pritet gjatë aktiviteteve të zakonshme shkollore.

Miratimi i informuar shërben për t'i bërë me dije prindin/kujdestarin ligjor për shërbimin psiko-social që fëmijës i ofrohet brënda institucionit arsimor dhe prindi/kujdestari ligjor miraton me shkrim çdo fillim viti shkollor. (*sipas shtojcës 1/ shtojcës 2*).

Prindit/kujdestarit ligjor duhet t'i merret miratimi i informuar kur punonjësi i shërbimit psiko-social synon t'u japë nxënësve një instrument matës që grumbullon të dhëna dhe nevojitet publikimi i tyre (foto, të dhëna personale dhe familjare etj) ose kur këto të dhëna përdoren përsye të ndryshme kërkimore ose studimore.

Standardi I.1.2 Miratimi/pëlqimi për krijimin e një marrëdhënieje punonjës i shërbimit psiko-social-nxënës

Me përjashtim të situatave të emergjencës ose vetëreferimeve nga një nxënës, punonjësit e shërbimit psiko-social kërkojnë miratimin/pëlqimin e prindërve/ kujdestarit ligjor, para krijimit të një marrëdhënieje profesionale punonjës i shërbimit psiko-social-nxënës, në shkollë, përsye të diagnozës psikologjike dhe mjekësore, të vlerësimit të përshtatshmërisë për arsim special ose aftësinë e kufizuar, përsye të testim individual/grup ose ndërhyrje të tjera, të nevojshme përsye të nxënësin (shih *miratimin/pëlqimin e informuar* në përkufizimin e termave).

I.1.2a Është etikisht e lejueshme të sigurohet ndihmë psiko-sociale, pa njoftimin ose miratimin/pëlqimin e prindërve/kujdestarit ligjor, në situata emergjente ose nëse ka arsyet e

besohet se një nxënës mund të paraqesë rrezik për të tjerët, është në rrezik për vetëdëmtim ose është në rrezik lëndimi, shfrytëzimi ose keqtrajtimi.

I.1.2b Kur një nxënës vetëreferohet për ndihmë, është etikisht e lejueshme të sigurohet ndihmë psiko-sociale, pa njoftimin ose pa pëlqimin e prindërve, për një ose disa takime, për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e nevojës për shërbime dhe për të siguruar që fëmija është i sigurt dhe nuk është në rrezik. Është etikisht e lejueshme të ofrohen shërbime për nxënës, pa miratimin/pëlqimin e prindërve, aty ku lejon legjislacioni në fuqi. Sidoqoftë, nëse nxënësi nuk ka mbushur moshën për vendimmarrje, për të marrë ndihmë psiko-sociale në shkollë, pavarësisht miratimit/pëlqimit të prindërve/kujdestarit ligjor, punonjësi i shërbimit psiko-social për të siguruar ndihmë të vazhdueshme për nxënësin, përtej takimeve paraprake e informon atë në burime alternative të ndihmës (linjë këshillimi falas, këshillim online, etj.), që nuk kërkojnë njoftim ose pëlqim të prindërve.

Standardi I.1.3 Kërkimi i miratimit/pëlqimit të informuar

Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë, që individi i cili jep miratimin/pëlqimin për shërbimet psiko-sociale të shkollës, të jetë plotësisht i informuar në lidhje me natyrën dhe me fushën e shërbimeve të ofruara, me qëllimet dhe me procedurat e vlerësimit/ndërhyrjes, me çdo rrezik të parashikueshëm dhe me përfitimet që mund të priten në mënyrë të arsyeshme. Shpjegimi përfshin diskutimin e kufijve të konfidencialitetit, ndarjen e informacionit në lidhje me hapat, me rezultatet dhe me pritshmërinë e mundshme të ofrimit të shërbimeve të vlerësimit/ndërhyrjes. Shërbimet alternative të disponueshme identifikohen, nëse janë të përshtatshme. Ky shpjegim i miratimit/pëlqimit të informuar, merr parasysh dallimet gjuhësore dhe kulturore, aftësitë njoħe se, nivelin e zhvillimit, moshën dhe faktorë të tjerë përkatës, në mënyrë që të kuptohet nga individi që jep miratimin/pëlqimin. Punonjësit e shërbimit psiko-social dokumentojnë në mënyrë të përshtatshme miratimin/pëlqimin, me shkrim ose me gojë.

Standardi I.1.4 Aprovimi

Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë pjesëmarrjen vullnetare të një nxënësi në vendimmarrje, në lidhje me shërbimet psiko-sociale të shkollës, sa më shumë të jetë e mundur. Zakonisht, punonjësit e shërbimit psiko-social kërkojnë miratimin verbal të nxënësit për shërbimet, megjithatë është etikisht e lejueshme të anashkalohet aprovimi i nxënësit për

shërbimet, nëse shërbimi konsiderohet të jetë me përfitim të drejtpërdrejtë për nxënësin dhe/ose kërkohet me ligj.

I.1.4a Nëse nxënësi nuk jep aprovin verbal për shërbimet, punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtën e nxënësit, megjithatë e informojnë nxënësin në lidhje me shërbimet e ofruara.

I.1.4b Kur një nxënësi i jepet mundësi zgjedhjeje, në lidhje me pranimin ose me refuzimin e shërbimeve, punonjësi i shërbimit psiko-social sigurohet, që nxënësi të kuptojë atë që i ofrohet, respekton zgjedhjen e dekluarar të nxënësit dhe mbron nxënësin nga trysnia e zgjedhjeve, që nxënësi nuk dëshiron të bëjë ose nuk është në gjendje të bëjë.

Standardi I.1.5 E drejta për të refuzuar ose për të térhequr miratimin/pëlqimin

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë dëshirat e prindërve/kujdestarëve ligjor që kundërshtojnë shërbimet psiko-sociale të shkollës, dhe përpiken të udhëzojnë prindërit/kujdestarin ligjor drejt burimeve alternative. Punonjësit e shërbimit psiko-social lejojnë prindërit/kujdestarët ligjor të térheqin miratimin/pëlqimin në çdo kohë, pa pasoja negative.

Parimi i përgjithshëm I.2 Privatësia dhe konfidencialiteti

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtën e personave që të zgjedhin vetë, nëse do të zbulojnë mendimet, ndjenjat, besimet dhe sjelljet e tyre private.

Standardi I.2.1 Informacion lidhur me privatësinë

Punonjësit e shërbimit psiko-social minimizojnë ndërhyrjet në privatësi. Ata nuk kërkojnë ose nuk ruajnë informacione private për nxënësit, që nuk janë të nevojshme ose që nuk ndikojnë në ofrimin e shërbimeve. Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë se komunikimet punonjës i shërbimit psiko-social-nxënës, janë ekskluzivitet i kompetencave profesionale dhe janë vetëm

për punonjësin e shërbimit psiko-social të shkollës. Ata nuk zbulojnë ose nuk ruajnë në regjistrat e tyre të të dhënave, ndonjë informacion të veçantë, përveçse kur lejohet nga legjislacioni në fuqi, ruajtja e informacionit të veçantë përfshin ofruesit e shërbimeve të shëndetit mendor. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një model të zgjidhjes së problemeve, për të shqyrtuar me kujdes, nëse do të ndajnë me palët e treta informacione që mund ta vënë nxënësin, familjen ose të tjerët në rrezik juridik, social ose tjeter. Kur punonjësit e shërbimit psiko-social marrin një raport nga një profesionist jashtë sistemit shkollor, që përfshin informacion ndërhyrës në privatësinë e familjes, dhe nuk është i nevojshëm përmarrjen e vendimeve në shkollë, ata marrin në konsideratë kthimin e raportit te krijuesi, me një kërkesë për redaktimin e informacionit të tepërt, kjo është mënyra më e mirë e veprimit.

Standardi I.2.2 Limitet e konfidencialitetit

Punonjësit e shërbimit psiko-social informojnë nxënësit dhe palët e tjera të përfshira direkt ose indirekt për kufijtë e konfidencialitetit, në fillim të krijimit të një marrëdhënieje profesionale. Ata kërkojnë mirëkuptim të përbashkët me nxënësit dhe me palët e tjera të përfshira direkt ose indirekt, në lidhje me llojet e informacionit që duan dhe nuk do të ndahet me palët e treta. Sidoqoftë, nëse një nxënës ka nevojë për ndihmë të menjëhershme, lejohet të shtyhet diskutimi i konfidencialitetit, derisa të zgjidhet kriza e menjëhershme.

Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë se mund të jetë e nevojshme të diskutohet konfidencialiteti, në pikë të shumta në një marrëdhënie profesionale, për të siguruar mirëkuptimin dhe marrëveshjen, në lidhje me mënyrën se si do të trajtohen zbulimet dhe informacionet sensitive.

Standardi I.2.3 Miratimi/pëlqimi për zbulimin e informacionit

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë punës së tyre profesionale.

Informacioni nuk u zbulohet palëve të treta, pa miratimin/pëlqimin e prindërve/kujdestarëve ligjor të një fëmije, përveçse në ato situata kur mbajtja e fshehtë e informacionit mund të rezultojë në rrezik për nxënësin ose të tjerët, ose kur kërkohet ndryshe nga ligji. Kurdo që të

jetë e mundur, aprovimi i nxënësit merret para zbulimit të konfidencialitetit te palët e treta, përfshirë këtu prindërit enxënësit. Kur kërkojnë konsultime për një nxënës jashtë institucionit arsimor (p.sh.: rrjeti profesional, njësia e shërbimit psiko-social, forumet online etj.), punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që informacioni i kërkuar, nuk rrezikon zbulimin e identitetit të nxënësit.

Standardi I.2.4 Nevoja për të ditur/orientim profesional

Punonjësit e shërbimit psiko-social diskutojnë dhe/ose lëshojnë informacion konfidencial, vetëm për qëllime profesionale dhe vetëm me persona që kanë nevojë legjitime për ta ditur. Ata e bëjnë këtë, brenda kufijve të rreptë të parimeve etike të privatësisë dhe Kodeve të Etikës dhe Deontologjisë, të urdhreve përkatëse.

Standardi I.2.5 Privatësia lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtën e privatësisë së nxënësve, të prindërve dhe të kolegëve, në lidhje me orientimin seksual, identitetin gjinor ose statusin transgjinor. Ata nuk ndajnë informacion në lidhje me orientimin seksual, identitetin gjinor ose statusin transgjinor të një nxënësi (përfshirë të miturit), të një prindi ose punonjësi të shkollës me askënd, pa lejen e atij individi.

Standardi I.2.6 Privatësia e informacionit shëndetësor

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtën e privatësisë së nxënësve, të prindërve të tyre dhe të anëtarëve të tjerë të familjes dhe të kolegëve, në lidhje me informacionin e ndjeshëm shëndetësor (p.sh., praninë e një sëmundjeje, ku ruajtja e konfidencialitetit është detyrim ligjor). Ata nuk ndajnë informacione të ndjeshme shëndetësore në lidhje me një nxënës, prind ose punonjës të shkollës, me të tjerët, pa lejen e atij individi (ose lejen e një prindi ose kujdestari në rastin e një të mituri). Punonjësit e shërbimit psiko-social konsultohen me institucionet përgjegjëse për shëndetin publik për udhëzime, nëse ata besojnë se një nxënës paraqet rrezik shëndetësor për të tjerët.

Parimi i përgjithshëm I.3 Komunikimi

Komunikimi etik i punonjësit të shërbimit psiko-social në shkolla, është një element thelbësor për të ndërtuar një mjedis të sigurt, bashkëpunues dhe të respektueshëm për nxënësit, stafin dhe prindërit. Ai duhet të bazohet në parime të forta të etikës profesionale dhe të respektimit të të drejtave të njeriut.

Në thelb, komunikimi etik punonjësit të shërbimit psiko-social nuk është thjesht një mënyrë të foluri, por një **qasje e përgjegjshme, profesionale dhe njerëzore** ndaj detyrës. Ai është një pasqyrë e karakterit dhe të integritetit të punonjësit të shërbimit psiko-social në funksion të një mjedisi të sigurt arsimor.

Standardi I.3.1 Respekti dhe dinjiteti

Respekti dhe dinjiteti nënkuptojnë **një sjellje njerëzore, të barabartë dhe të drejtë**, ku çdo individ trajtohet me vlerë të natyrshme dhe pa diskriminim. Punonjësi i shërbimit psiko-social është shembull i kësaj sjelljeje në mjedisin shkollor. Punonjësi i shërbimit psiko-social në shkolla duhet të përdorë gjithmonë gjuhë të sjellshme dhe të kulturuar, pavarësisht situatës. Ai nuk duhet të përdorë shprehje denigruese, ironike apo tallëse ndaj nxënësve, stafit apo prindërve dhe të tregojë kujdes të veçantë në komunikimin me fëmijët dhe adolescentët, duke respektuar ndjeshmërinë e moshës.

Standardi I.3.2 Komunikimi i qartë dhe i kuptueshëm

Komunikimi i qartë dhe i kuptueshëm shërben për të siguruar mirëkuptim, bashkëpunim dhe siguri në çdo ndërveprim, që punonjësi i shërbimit psiko-social ka me nxënësit, stafin dhe palët e tjera të përfshira në jetën shkollore. Punonjësi i shërbimit psiko-social duhet të japë udhëzime të qarta, të thjeshta dhe të drejtpërdrejta dhe të shmangë fjalët teknike ose gjuhën e pakuptueshme për nxënësit. Ai duhet të sigurohet që mesazhet të jenë të kuptuara saktë, sidomos në raste emergjente.

Standardi I.3.3 Dëgjimi aktiv dhe empatia

Dëgjimi aktiv dhe empatia janë dy nga aftësítë më të rëndësishme që një punonjës i shërbimit psiko-social në shkollë duhet të ketë, sepse ato ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si ai

ndërton marrëdhënie të shëndetshme, të besueshme dhe njerëzore me nxënësit dhe me komunitetin shkollor.

Punonjësi i shërbimit psiko-social duhet të dëgjojë me vëmendje dhe pa paragjykim çdo person që i drejtohet dhe duhet të tregojë gatishmëri për të ndihmuar dhe për të kuptuar problemet nga këndvështrimi i tjetrit. Ai duhet të respektojë ndjenjat dhe përjetimet emocionale të nxënësve, duke ruajtur profesionalizmin.

Standardi I.3.4 Qetësia dhe vetëkontrolli

Qetësia dhe vetëkontrolli përfaqësojnë aftësinë e punonjësit të shërbimit psiko-social për të ruajtur një qëndrim të përmbajtur emocionalisht dhe të matur në sjellje dhe komunikim, pavarësisht nga natyra e situatave me të cilat përballet.

Punonjësi i shërbimit psiko-social duhet të mbajë tonin e zërit të ulët, të qëndrueshëm dhe të qetë, edhe në situata të tensionuara dhe të shmangë ngritjen e zërit, kërcënimet verbale apo ndërhyrjet agresive. Ai duhet të japë shembull me sjellje të matur dhe të përmbajtur.

Standardi I.3.5 Bashkëpunimi

Punonjësi i shërbimit psiko-social duhet të inkurajojë dialog dhe zgjidhje përmes bashkëpunimit dhe të jetë i hapur për sugjerime dhe kritikë konstruktive nga stafi pedagogjik. Ai duhet të punoje në sinkron me shërbimin psiko-social dhe strukturat drejtuese apo struktura të tjera jashtë shkollës për të adresuar problematika.

Parimi i përgjithshëm I.4 Paanshmëria, drejtësia dhe barazia

Në fjalët dhe veprimet e tyre, punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë paanshmërinë dhe drejtësinë sociale. Ata përdorin ekspertizën e tyre, për të kultivuar klimë shkollore të sigurt, të barabartë dhe mikpritëse për të gjithë personat, pavarësisht nga karakteristikat aktuale ose të perceptuara, duke përfshirë racën, përkatësinë etnike, ngjyrën, fenë, prejardhjen, origjinën kombëtare, statusin e imigrimit, statusin socio-ekonomik, gjuhën parësore, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor, paaftësinë ose ndonjë karakteristikë tjetër dalluese.

Standardi I.4.1 Diskriminimi

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk angazhohen ose nuk pranojnë veprime ose politika që diskriminojnë personat, përfshirë nxënësit dhe familjet e tyre, përfituesit e tjerë të shërbimit, mbikëqyrësit dhe kolegët, bazuar në karakteristikat aktuale ose të perceptuara.

Standardi I.4.2 Korrigjimi i praktikave diskriminuese

Punonjësit e shërbimit psiko-social përpiken të sigurojnë, që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta, për të marrë pjesë dhe pér tē përfituar nga programet shkollore, që të gjithë nxënësit dhe familjet të kenë akses dhe mund tē përfitojnë nga shërbimet psiko-sociale të shkollës. Ata punojnë pér tē korrigjuar praktikat shkollore që janë padrejtësisht diskriminuese ose që u mohojnë nxënësve ose të tjerëve, të drejtat e tyre ligjore. Punonjësit e shërbimit psiko-social ndërmarrin hapa, pér tē nxitur një klimë shkollore që është e sigurt, mbështetëse, gjithëpërfshirëse, pranuese dhe respektuese ndaj të gjithë personave, veçanërisht atyre që kanë përjetuar marginalizim në mjediset arsimore.

FUSHA II: KOMPETENCA DHE PËRGJEGJËSIA PROFESSIONALE

Përfitim ose kujdesi përgjegjshëm do të thotë që punonjësit shërbimit psiko-social veprojnë në dobi të tjerëve. Për ta bërë këtë, punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të praktikojnë brenda kufijve të kompetencës së tyre, të përdorin njohuritë shkencore nga psikologjia/puna sociale dhe edukimi, për të ndihmuar nxënësit dhe të tjerët, të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të pranojnë përgjegjësinë për punën e tyre.

Parimi i përgjithshëm II.1 Kompetenca

Punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen vetëm në praktika për të cilat ata janë të kualifikuar dhe kompetentë. Për të ruajtur kompetencën, ata angazhohen në zhvillimin e vazhduar profesional. Ata e kuptojnë se zhvillimi i aftësive profesionale përtej formimit fillestar, kërkon një program të mirëplanifikuar të zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe të supervizimit profesional. Përveç kësaj, brenda mjedisit të tyre të punës, ata advokojnë për burimet dhe mbështetjen e nevojshme, për të ruajtur efektivitetin profesional dhe mirëqenien personale.

Standardi II.1.1 Praktika në fushën e kompetencës

Punonjësit e shërbimit psiko-social njojin pikat e forta dhe kufizimet e përgatitjes dhe përvojës së tyre të diplomimit, duke u angazhuar vetëm në praktikat për të cilat ata janë të kualifikuar. Ata kërkojnë ndihmën e specialistëve të tjerë në rolet supervizuese, këshilluese ose referuese, sipas rastit, në ofrimin e shërbimeve efektive. Kur nuk ka asnje ofrues të përshtatshëm, punonjësit e shërbimit psiko-social u shpjegojnë prindërve kufizimet e përvojës së tyre dhe kërkojnë konsultime, zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe supervizim, si mundësi të përshtatshme dhe të nevojshme, për të siguruar që nxënësit të marrin shërbimin e nevojshëm.

Standardi II.1.2 Respektimi i orarit zyrtar të punës

Respektimi i orarit të detyrës nga punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë, nënkupton përm bushjen me përpikëri të detyrimeve të tij brenda kohës së përcaktuar në kontratën individuale, mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë (ligji nr.7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar). Kjo është një pjesë thelbësore e etikës profesionale dhe e përgjegjshmërisë së punonjësit të shërbimit psiko-social. Ja çfarë përfshin konkretisht:

1. Prania në institucion para hyrjes së nxënësve.
2. Qëndrimi i pandërprerë gjatë orarit mësimor.
3. Largimi vetëm pas mbylljes së orarit të shkollës.

Orari zyrtar i punës për punonjësin e shërbimit psiko-social në shkollë nuk është thjesht një kornizë kohore, por është garancia që shëndeti mendor në institucion është e mbuluar në çdo moment të parashikuar nga rregullorja. Kur ky orar nuk respektohet, më shumë se sa një vonesë fizike, kemi një cenim të drejtpërdrejtë të përgjegjësisë ndaj komunitetit shkollor.

Do të konsiderohet shkelje e orarit zyrtar të punës:

1. Mungesa pa arsyte të justifikuar
2. Arritja me vonesë në shkollë
3. Largimi nga mjediset shkollore gjatë orarit të punës
4. Mosrespektimi i turneve (kur zbatohet metoda me dy turne).

Standardi II.1.3 Kodi i veshjes

Kodi i veshjes për punonjësin e shërbimit psiko-social në shkollat, në Shqipëri, është i përcaktuar me kujdes, për të ruajtur një ekuilibër mes autoritetit dhe afërsisë, duke respektuar natyrën edukative të mjedisit shkollor.

Qëllimi i këtij kodi veshjeje është që punonjësi i shërbimit psiko-social në shkolla, të jetë i dallueshëm, të ruajë një autoritet moral, të jetë në harmoni me mjedisin shkollor dhe të përçojë besueshmëri dhe profesionalizëm.

Veshja etike e punonjësit të shërbimit psiko-social është një element thelbësor i profesionalizmit dhe përfaqësimit institucional. Ajo nuk është thjesht një zgjedhje estetike, por

një formë komunikimi që përçon respekt, seriozitet dhe përkushtim ndaj rolit që ai ushtron në komunitetin shkollor. Nëpërmjet një veshjeje të pastër, të përmbajtur dhe të përshtatshme me standardet e institucionit, punonjësi i shërbimit psiko-social tregon se është një figurë e besueshme dhe e gatshme për të mbrojtur mirëqenien e të gjithëve.

Për nxënësit, mësuesit dhe prindërit, mënyra si paraqitet punonjësi i shërbimit psiko-social, ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën si ai perceptohet. Një punonjës i shërbimit psiko-social, që vishet në mënyrë etike dhe korakte, fiton respektin e komunitetit dhe krijon një atmosferë sigurie, disipline dhe profesionalizmi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, në një mjedis arsimor, ku ai shërben edhe si model edukimi përfmijët dhe të rinjtë.

Për më tepër, veshja etike ndihmon në ruajtjen e integritetit të rolit, duke nxitur sjellje të përmbajtura, të paanshme dhe në përputhje me normat profesionale. Ajo gjithashtu, siguron që punonjësi i shërbimit psiko-social të jetë lehtësisht i identifikueshëm nga të gjithë, në rast nevoje apo situatash emergjente, duke përforcuar funksionin e tij në garantimin e mirëqënieς.

Në thelb, veshja etike është një shprehje e qartë e etikës së punës dhe e përkushtimit ndaj misionit të mbrojtjes dhe të edukimit përmes shembullit.

Punonjësi i shërbimit psiko-social ka detyrimin të ketë veshje dhe paraqitje serioze, që t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës. Veshja etike mund të konsiderohet:

- Veshje civile, por zyrtare dhe etike
- Këmishë e bardhë ose blu e hapur ose bluzë me jakë serioze
- Pantallona materiale klasike ose xhinse, fustan ose fund, ngjyrë e errët
- Këpucë të myllura dhe zyrtare, atlete ose sandale
- Xhaketë, jelek apo pallto në ditët e ftohta, gjithashtu në ngjyra neutrale
- Kujdes për higjienën personale dhe paraqitjen e jashtme.

Çfarë është e ndaluar në veshjen e punonjësit të shërbimit psiko-social?

Punonjësit të shërbimit psiko-social i ndalohet:

- Veshje që eksposojnë trupin
- Të duket trupi ndërmjet veshjeve të sipërme dhe të poshtme
- Simbolet partiake, fetare apo të markave të dallueshme

- Pantallonat e shkurtra
- Xhinse të grisura, t-shirt me figura ose mbishkrime
- Kapele dhe syzet e diellit gjatë procesit të punës
- Kapele, syze të errëta brenda mjedisit të shkollës
- Veshje sportive.

Standardi II.1.4 Problemet personale

Punonjësit e shërbimit psiko-social tregojnë kujdes ndaj aktivitetave të lidhura me punën ku problemet e tyre personale mund të ndërhyjnë në efektivitetin profesional. Ata kërkojnë konsultim ose ndihmë tjetër, kur shfaqen probleme personale, që kërcënojnë të komprometojnë efektivitetin e tyre profesional.

Standardi II.1.5 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen në zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Ata përditësohen me zhvillimet në kërkime, me zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe me praktikat profesionale, prej të cilave përfitojnë fëmijët dhe të rinjtë, familjet dhe shkollat.

Parimi i përgjithshëm II.2 Pranimi i përgjegjësisë për veprimet

Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë përgjegjësinë për punën e tyre profesionale, monitorojnë efektivitetin e shërbimeve të tyre dhe punojnë për të korriguar rekomandimet joefektive.

Standardi II.2.1 Saktësia e dokumenteve

Punonjësit e shërbimit psiko-social i rishikojnë të gjitha dokumentet e tyre të shkruara dhe i nënshkruajnë ato vetëm kur janë të sakta. Ata mund të shtojnë informacion, në një dokument të datuar dhe të nënshkruar më parë, nëse informacioni konstatohet se është i pasaktë ose jo i

plotë. Në raportet ose dokumentet multidisiplinare, punonjësit e shërbimit psiko-social janë etikisht përgjegjës vetëm për saktësinë e kontributeve të tyre.

Standardi II.2.2 Monitorimi i progresit

Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që efektet e rekomandimeve dhe të planeve të tyre të ndërhyrjes, të monitorohen personalisht ose nga të tjerët. Ata rishikojnë një rekomandim, modifikojnë ose përfundojnë një plan ndërhyrjeje, kur të dhënrat tregojnë se rezultatet e dëshiruara nuk janë arritur. Punonjësit e shërbimit psiko-social kërkojnë ndihmën e të tjerëve në role supervizuese, mbikëqyrëse, këshilluese ose referuese, kur monitorimi i progresit tregon se rekomandimet dhe ndërhyrjet e tyre, nuk janë efektive në ndihmën e një nxënësi.

Standardi II.2.3 Përshtatshmëria e rekomandimeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë përgjegjësinë për përshtatshmërinë e praktikave, të vendimeve dhe të rekomandimeve të tyre profesionale. Ata korrigojnë keqkuptimet që rezultojnë nga rekomandimet, këshillat ose informacionet e tyre, dhe marrin hapa të nevojshëm, për të kompensuar çdo pasojë të dëmshme të rekomandimeve joefektive ose të papërshtatshme.

Standardi II.2.4 Përgjegjësia për punën e studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale

Kur mbikëqyrin përvojat ose praktikat në terren të studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale, punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë përgjegjësinë profesionale për punën e personave që kanë nën mbikëqyrjen e tyre.

Parimi i përgjithshëm II.3 Vlerësimet e përgjegjshme dhe praktikat e ndërhyrjes

Punonjësit e shërbimit psiko-social mbajnë standardin më të lartë për praktikat profesionale të përgjegjshme, në vlerësimin edukativ e psiko-social dhe në ndërhyrjet direkt dhe indirekte. Ky parim udhëzues dhe standardet e tij janë të zbatueshme për praktikat e vlerësimit dhe të ndërhyrjes në shkollë, përfshirë ato që përdorin teknologji, të tilla si formatet kompjuterike/digitale për vlerësimin dhe interpretimin, për vlerësimin dhe ndërhyrjen e realitetit virtual, për vlerësimin në distancë ose ndonjë formati tjeter të vlerësimit ose të ndërhyrjes.

Standardi II.3.1 Konsiderata para përcaktimit të aftësisë së kufizuar

Para shqyrtimit të një kategorie të aftësisë së kufizuar, merren parasysh efektet e menaxhimit aktual të sjelljes dhe/ose praktikave mësimore në performancën e nxënësit në shkollë.

Standardi II.3.2 Teknikat e vlerësimit

Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin teknika dhe praktika vlerësimi që profioni i konsideron si praktika të përgjegjshme, të bazuara në kërkime.

Standardi II.3.3 Përzgjedja e instrumenteve

Punonjësit e shërbimit psiko-social përzgjedhin instrumentet dhe strategjitë e vlerësimit që janë të besueshme dhe të vlefshme, për të ekzaminuar dhe për të vlerësuar. Kur përdorin instrumente të standardizuara, punonjësit e shërbimit psiko-social u përbahen procedurave për administrimin e instrumentit, që ofrohen nga autori ose botuesi i instrumentit. Nëse bëhen modifikime në procedurat e administritimit për testet e standardizuara ose instrumente të tjera, modifikime të tilla identifikohen dhe diskutohen në interpretimin e rezultateve.

Standardi II.3.4 Të dhënat normative

Nëse përdorin matje të mbështetura në norma apo shkallë matëse të përcaktuar, punonjësit e shërbimit psiko-social zgjedhin instrumente që janë përfaqësuese dhe të përshtatshme për personin që vlerësohet. Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë supervizorët e tyre të informohen për rëndësinë e përdorimit të versionit më aktual të instrumenteve të publikuara.

Standardi II.3.5 Administrimi dhe vlerësimi digjital

Kur përdorin vlerësime të administruara në mënyrë digitale (p.sh.: kompjuter, tableta, realitet virtual) dhe/ose programe të vlerësimit ose të interpretimit, të ndihmuar nga kompjuteri, punonjësit e shërbimit psiko-social zgjedhin programe, që plotësojnë standartet profesionale për saktësinë dhe për vlefshmérinë. Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin gjykimin profesional, në vlerësimin e saktësisë së gjetjeve të vlerësimit të asistuar në mënyrë digitale për të ekzaminuarin.

Standardi II.3.6 Shumëllojshmëria e burimeve të të dhënave

Një vlerësim psiko-social ose psiko-edukativ bazohet në shumë burime të ndryshme të informacionit. Asnjë test ose instrument i vetëm nuk përdoret për të bërë përcaktim të gjera, në lidhje me identifikimin e aftësisë së kufizuar ose me shërbimet të tjera të nevojshme.

Standardi II.3.7 Vlerësimi gjithëpërfshirës

Në përputhje me ligjin e arsimit parauniversitar dhe me praktikat e mira profesionale, punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë, që nxënësit me aftësi të kufizuara, të vlerësohen në të gjitha fushat që lidhen me aftësinë e kufizuar.

Standardi II.3.8 Vlefshmëria dhe drejtësia

Punonjësit e shërbimit psiko-social kryejnë vlerësime të vlefshme dhe të drejta. Ata ndjekin në mënyrë aktive, njohuritë për aftësitë e kufizuara të nxënësit dhe sfondin zhvillimor, kulturor, gjuhësor dhe eksperimental dhe pastaj, përzgjedhin, administrojnë dhe interpretojnë

instrumentet dhe procedurat e vlerësimit, bazuar te karakteristikat përkatëse. Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë, që rezultatet e vlerësimit të përdoren për të rritur mundësitë e të nxënësit për nxënësit.

Standardi II.3.9 Përkthyesit

Kur përkthyesit përdoren për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve të vlerësimit dhe të ndërhyrjes, punonjësit e shërbimit psiko-social kërkojnë caktimin e përkthyesve të kualifikuar dhe të pranueshëm për nxënësit.

Standardi II.3.10 Interpretimi i rezultateve

Punonjësit e shërbimit psiko-social interpretojnë në mënyrë adekuate gjetjet dhe paraqesin rezultatet në terma të qartë. Ata sigurojnë që marrësit të kuptojnë rezultatet e vlerësimit, në mënyrë që të mund të bëjnë zgjedhje të informuara.

Standardi II.3.11 Përzgjedhja e ndërhyrjes

Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin ndërhyrje, procedura këshillimi dhe teknika terapie, teknika konsultimi dhe metoda të tjera të shërbimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, që profesioni i konsideron si praktikë të përgjegjshme, të bazuara në të dhëna. Ata e bëjnë këtë, duke përdorur një proces të zgjidhjes së problemeve, për të zhvilluar ndërhyrje që janë të përshtatshme për problemet e paraqitura dhe në përputhje me të dhënat e mbledhura. Për më tepër, prioritet u jepet ndërhyrjeve të përshkruara në literaturën e hulumtimit profesional, të rishikuara dhe të gjitura, se janë efikase.

Standardi II.3.12 Përfshirja e prindërve në planifikimin e ndërhyrjes

Punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e prindërve/kujdestarëve ligjor në hartimin e ndërhyrjeve, përfshirë diskutimin e rekomandimeve dhe të planeve me prindërit, për të ndihmuar fëmijët e tyre. Kur është e përshtatshme, kjo përfshin lidhjen e ndërhyrjeve midis shkollës dhe familjes, të prindërve/kujdestarëve ligjor, duke marrë parasysh vlerat etnike/kulturore të familjes, duke ndihmuar prindërit të fitojnë

aftësitë e nevojshme, për të ndihmuar fëmijët e tyre. Prindërit/kujdestarët ligjor informohen për burimet e mbështetjes alternative të disponueshme në shkollë dhe në komunitet.

Standardi II.3.13 Aprovimi i nxënësit për ndihmë

Punonjësit e shërbimit psiko-social diskutojnë me nxënësit rekomandimet dhe planet për t'i ndihmuar ata. Në masën maksimale të përshtatshme dhe në përputhje me grupmoshën, nxënësit mund të ftohen të marrin pjesë në përzgjedhjen dhe në planifikimin e ndërhyrjeve.

Parimi i përgjithshëm II.4 Mbajtja e përgjegjshme e regjistratit të dhënavë

Punonjësit e shërbimit psiko-social ruajnë privatësinë e shënimeve, sigurojnë aksesin e prindërve/kujdestarëve ligjor në të dhënat e ruajtura të fëmijës së tyre, si dhe sigurojnë aksesin nxënësve të rritur në të dhënat e ruajtura.

Standardi II.4.1 Njoftimi i të drejtave dhe i përgjegjësive në lidhje me regjistrin e dhënavë

Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë që prindërit dhe nxënësit e rritur, të njoftohen për të drejtat e tyre, në lidhje me krijimin, modifikimin, ruajtjen dhe asgjësimin e të dhënavë psiko-sociale dhe arsimore, që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve. Prindërit/kujdestarët ligjor dhe nxënësit e rritur njoftohen për ruajtjen dhe për transmetimin elektronik të shënimeve psiko-sociale të shkollës, si dhe rreziqet e lidhura me privatësinë.

Standardi II.4.2 Regjistri i dhënavë gjithëpërfshirëse

Punonjësit e shërbimit psiko-social krijojnë dhe/ose mbajnë shëнимë psiko-sociale dhe arsimore në shkollë, me detaje të mjaftueshme, për të qenë të dobishëm në marrjen e vendimeve nga një profesionist tjeter dhe me detaje të mjaftueshme për t'i bërë ballë shqyrtimit, nëse sfidohen në një proces të rregullt ose procedurë tjeter ligjore.

Standardi II.4.3 Përbajtja e regjistratit të dhënavëve të nxënësve

Punonjësit e shërbimit psiko-social përfshijnë vetëm informacione të dokumentuara nga burime të besueshme në regjistrin e të dhënavëve (shtojca 3). Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk ruajnë në regjistrin e të dhënavëve ndonjë informacion privat për nxënësit ose familjet e tyre, që nuk është i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve shkollore (shihni *Standardin e Etikës II.4.8 Regjistrimet e pronësisë ekskluzive*).

Standardi II.4.4 E drejta për të inspektuar regjistrat

Punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë, që prindërit të kenë akses të përshtatshëm në të dhënat psiko-sociale dhe arsimore të fëmijëve të tyre, si dhe nxënësit e rritur të kenë akses në të dhënat e tyre. Prindërit/kujdestarët ligjor kanë të drejtë të kenë qasje në çdo informacion që përdoret, për të marrë vendime edukative për fëmijët e tyre; nxënësit e rritur kanë të drejtë të kenë qasje në çdo informacion të përdorur, për të marrë vendime edukative rrëth tyre.

Standardi II.4.5 Protokollet e testeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtën e prindërve/kujdestarëve ligjor (dhe nxënësve të rritur) për t'u njohur, por jo domosdoshmërisht për të kopjuar përgjigjet e fëmijës së tyre në detyrat e testit. Punonjësit e shërbimit psiko-social e kuptojnë se e drejta e prindërve/kujdestareve ligjor (dhe nxënësve të rritur), për të shqyrtuar përgjigjet e testit të fëmijës së tyre, mund të zëvendësojë interesat e botuesve të testit.

Standardi II.4.6 Qasja në regjistrime nga burimet njerëzore të shkollës

Në masën që të dhënat psiko-sociale të shkollës janë nën kontrollin e punonjësve të shërbimit psiko-social, ata sigurojnë që vetëm atyre, personelit të shkollës që kanë interes arsimor legjitim te një nxënës, t'u jepet qasje në të dhënat psiko-sociale të shkollës për atë nxënës, pa pasur paraprakisht lejen prindërore ose lejen e një nxënësi të rritur. Ky standard zbatohet për qasjen në regjistrat fizikë dhe elektronikë.

Standardi II.4.7 Mbajtja e regjistrimeve elektronike

Në masën që të dhënat psiko-sociale të shkollës janë nën kontrollin e punonjësve të shërbimit psiko-social, ata mbrojnë skedarët elektronikë nga lëshimi ose modifikimi i paautorizuar (p.sh., duke përdorur fjalëkalime dhe kriptim) dhe ndërmarrin hapa të arsyeshëm, për të siguruar që të dhënat psiko-sociale të shkollës nuk humbasin për shkak të dëmtimit/dështimit të pajisjeve.

Standardi II.4.8 Regjistrimet e pronësisë ekskluzive

Është etikisht e lejueshme që punonjësit e shërbimit psiko-social të mbajnë shënime që nuk janë të arritshme për të tjerët, për t'i përdorur si mjet ndihmues për kujtesën. Sidoqoftë, çdo informacion i përdorur, për të marrë vendime edukative në lidhje me një nxënës, është pjesë e regjistrit të të dhënavës dhe duhet të jetë i arritshëm për prindërit dhe për nxënësit e rritur.

Standardi II.4.9 Mbajtja dhe ruajtja e të dhënavës

Punonjësit e shërbimit psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit dhe me stafin tjeter të shkollës, punojnë për të krijuar politika që janë në përputhje me ligjin dhe praktikat e shëndosha profesionale, në lidhje me ruajtjen dhe me asgjësimin e të dhënavës psiko-sociale dhe personale të shkollës. Ata advokojnë për politika dhe për praktika që:

- a) ruajnë sigurinë e të dhënavës psiko-sociale të shkollës, duke lehtësuar aksesin e duhur në ato të dhëna, nga prindërit dhe nga nxënësit e rritur,
- b) identifikojnë afatet kohore për shqyrtimin periodik dhe asgjësimin e të dhënavës të vjetësuara psiko-sociale të shkollës, që janë në përputhje me ligjin dhe me praktikën e mirë profesionale,
- c) sigurojnë për të dhënat e vjetësuara psiko-sociale, shkatërrimin ose fshirjen e tyre, në një mënyrë që informacioni nuk mund të rikuperohet.

Për më tepër, punonjësit e shërbimit psiko-social mbrojnë një sistem të ofrimit të shërbimeve shkollore, në të cilin skicat e dokumenteve të punës (draftet) nuk ruhen në regjistrin e të dhënavës të nxënësve.

Parimi i përgjithshëm II.5 Përdorimi i përgjegjshëm i materialeve burimore

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, të atyre që prodhojnë teste, materiale ndërhyrëse, vepra shkencore dhe materiale të tjera. Ata nuk e pranojnë përdorimin e materialeve nga persona të pakualifikuar.

Standardi II.5.1 Siguria e testeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social ruajnë sigurinë e testit, duke parandaluar anashkalimin e parimeve themelore dhe të përmbajtjes specifike, që do të zhvleftësonin përdorimin e instrumentit. Punonjësit e shërbimit psiko-social u japin prindërve/kujdestareve ligjor (dhe nxënësve të rritur), mundësinë për të njohur dhe për të rishikuar përgjigjet e testit të fëmijës së tyre. Kur kërcohët nga ligji ose nga akte të tjera nënligjore, punonjësit e shërbimit psiko-social mund t'u japin prindërve/kujdestareve ligjor (ose nxënësve të rritur), kopje të raportit përfundimtar të testit të fëmijës së tyre. Me kërkesë të një prindi/kujdestari ligjor (ose nxënësi të rritur), është gjithashtu etikisht e lejueshme, që punonjësit e shërbimit psiko-social të kërkojnë, që ata si profesionistë, t'i bashkohen një grapi profesionistësh (me dy punonjës të tjërë), për aplikimin e protokollit të testit dhe/ose për t'i interpretuar ato. Punonjësit e shërbimit psiko-social mund të mos i nxjerrin të dhënat e testit, me qëllim mbrojtjen e nxënësit apo personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, nga një dëmtim serioz, keqpërdorim apo keqinterpretim i t ë dhënavë të testit. Në mungesë të një deklarate të dhënë nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, ata japin të dhënat e testit, vetëm nëse kërcohët me urdhër nga gjykata.

Standardi II.5.2 Përdorimi i materialeve të kufizuara

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk promovojnë dhe nuk pranojnë përdorimin e testeve psiko-sociale dhe psiko-edukative të kufizuara ose mjeteve/procedura të tjera të vlerësimit, nga individë të cilët nuk janë të kualifikuar për t'i përdorur ato.

Standardi II.5.3 Pronësia intelektuale

Punonjësit e shërbimit psiko-social njohin përpjekjet dhe shpenzimet e përfshira, në zhvillimin dhe në publikimin e testeve psiko-sociale dhe psiko-edukative, materialeve të ndërhyrjes dhe të punimeve shkencore. Ata respektojnë të drejtat e pronësisë intelektuale dhe interesat e të drejtave të autorit, të prodhuesve të materialeve të tillë, pavarësisht nëse materialet botohen në format të shtypur ose digjital. Ata nuk kopjojnë manuale testimi të mbrojtura nga të drejtat e autorit.

FUSHA III: NDERSHMËRIA DHE INTEGRITETI NË MARRËDHËNIET PROFESIONALE

Për të nxitur dhe për të ruajtur besimin, punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të jenë besnikë ndaj së vërtetës dhe t'u përmbahen premtive të tyre profesionale. Punonjësit e shërbimit psiko-social demonstrojnë integritet në marrëdhëniet profesionale.

Parimi i përgjithshëm III.1 Përfaqësim i saktë

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të hapur për kualifikimet, rolet e tyre dhe zhvillimin e kompetencave.

Standardi III.1.1 Prezantimi i saktë i kualifikimeve profesionale

Punonjësit e shërbimit psiko-social prezantojnë me saktësi kualifikimet e tyre profesionale te të tjera.

Standardi III.1.2 Korrigjimi i perceptimeve të gabuara

Punonjësit e shërbimit psiko-social korrigojnë çdo perceptim të gabuar të kualifikimeve të tyre. Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk e përfaqësojnë veten, si specialistë në një fushë të caktuar, pa përgatitje të verifikueshme.

Standardi III.1.3 Anëtarësimi dhe përvoja

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk përdorin lidhjet me persona, me shoqata ose me institucionë, që tejkalon atë që ata kanë arritur në të vërtetë.

Parimi i përgjithshëm III.2 Shpjegimi i drejtë i shërbimeve, i roleve dhe i përparësive profesionale

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të sinqertë për natyrën dhe për fushën e shërbimeve të tyre.

Standardi III.2.1 Shpjegimi i shërbimeve për nxënësit

Punonjësit e shërbimit psiko-social shpjegojnë kompetencat, rolet, detyrat dhe marrëdhëniet e tyre profesionale, te personat që marrin shërbime dhe te të tjerët në mjeshterin e tyre të punës, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të kuptueshme. Punonjësit e shërbimit psiko-social u shpjegojnë të gjitha shërbimet profesionale nxënësve dhe palëve të tjera të përfshira, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

Standardi III.2.2 Prioriteti mirëqenia e fëmijës

Angazhimi i punonjësit të shërbimit psiko-social për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinxve, i komunikohet administratës së shkollës, stafit dhe të tjerëve, si përparësia e tyre më e lartë në ofrimin e shërbimeve. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të detyruar etikisht, të flasin për interesat dhe të drejtat e nxënësve dhe të familjeve, edhe kur mund të jetë e vështirë për ta bërë këtë.

Standardi III.2.3 Papajtueshmëria

Punonjësit e shërbimit psiko-social të cilët ofrojnë shërbime për disa grupe të ndryshme (p.sh.: familjet, mësuesit, klasat), mund të hasin situata të papajtueshmërisë. Sa më shumë që të jetë e

mundur, punonjësit e shërbimit psiko-social u bëjnë të ditur përparësinë dhe angazhimet e tyre, paraprakisht të gjitha palëve, për të parandaluar keqkuptimet.

Parimi i përgjithshëm III.3 Respektimi i profesionistëve të tjerë

Për të përmbushur më së miri nevojat e fëmijëve, punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë, në marrëdhënie të bazuara në respektin reciprok.

Standardi III.3.1 Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë

Për të përmbushur nevojat e fëmijëve dhe të rinjve në mënyrë më efektive, punonjësit e shërbimit psiko-social bashkëpunojnë me psikologë, me punonjës socialë dhe me profesionistë nga disiplina të tjera, në marrëdhënie të bazuara në respektin reciprok. Ata marrin në konsideratë kontributin e profesionistëve joshkollarë, në lidhje me vlerësimin e nxënësve, me diagnozën dhe me ndërhyrjet e përshtatshme, që mund të kryhen brenda shkollës. Ata nxisin dhe mbështesin përdorimin e të gjitha burimeve, për t'i shërbyer interesit më të lartë të nxënësit. Nëse një nxënës merr shërbime të ngjashme nga një profesionist tjetër, punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë koordinimin e shërbimeve dhe shërbimt aty ku është e mundur, ofrimin e të njëjtë shërbim në mënyrë paralele.

Standardi III.3.2 Referimet te profesionistët e tjerë

Nëse një fëmijë i referohet një profesionisti tjetër për shërbime, punonjësit e shërbimit psiko-social sigurojnë, që të gjitha palët, përfshirë nxënësin, të njoftohen për ndryshimin dhe për arsyet e ndryshimit. Kur referohen nxënësit te profesionistë të tjerë, punonjësit e shërbimit psiko-social u japid nxënësve dhe prindërve/kujdestarit ligjor, rekomandimin me shkrim dhe një listë të institucioneve të përshtatshme nga të cilat mund të kërkojnë shërbime.

Standardi III.3.3 Ndryshimi i raporteve

Përveç kur supervizojnë studentët gjatë praktikës mësimore dhe praktikantët gjatë praktikës profesionale, punonjësit e shërbimit psiko-social nuk i ndryshojnë raportet e plotësuara nga një profesionist tjetër pa lejen e tyre.

Parimi i përgjithshëm III.4 Integriteti në marrëdhënie

Punonjësit e shërbimit psiko-social shhangin marrëdhëniet e shumta që pakësojnë efektivitetin e tyre profesional.

Standardi III.4.1 Marrëdhëniet e shumëfishta dhe efektiviteti profesional

Punonjësit e shërbimit psiko-social tregohen të përmbajtur në aktivitete ku marrëdhëniet e shumta me një nxënës ose familjen e nxënësit priren të ndërhyjnë në efektivitetin profesional. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të kujdeshëm në lidhje me veprimtarinë dhe marrëdhëniet e tjera me nxënësit, që mund të ndërhyjnë në gjykimin dhe në vendimmarjen profesionale ose kanë mundësi të rezultojnë si shfrytëzim i një nxënësi. Kur marrëdhëniet e shumta kërcënojnë të zvogëlojnë efektivitetin profesional ose do të shiheshin nga publiku si të papërshtatshme, punonjësit e shërbimit psiko-social kërkojnë nga drejtuesi i shkollës të rishpérndajë përgjegjësitetë ose e drejtojnë nxënësin në shërbime alternative.

Standardi III.4.2 Marrëdhëniet e shumëfishta dhe shërbimet alternative të limituara

Në situata në të cilat marrëdhëniet e shumta janë të pashmangshme, si p.sh., kur ka mungesë të ofruesve të shërbimeve alternative, punonjësit e shërbimit psiko-social marrin hapat e nevojshëm, për të parashikuar dhe për të parandaluar kushtet që mund të komprometojnë objektivitetin, profesionalizmin e tyre ose aftësinë për të ofruar shërbime. Ata vendosin dhe mbajnë kufij të qartë profesionalë, sqarojnë rolin e tyre dhe korrigjojnë çdo keqkuptim që mund

të ndikojë negativisht në mirëqenien e një nxënësi ose familjen e nxënësit. Në të gjitha rastet, punonjësit e shërbimit psiko-social u japid përparësi nevojave të nxënësit dhe përpilen të zgjidhin çdo konflikt që shfaqet, në një mënyrë që siguron përfitimin më të madh për nxënësin.

Standardi III.4.3 Ngacmimi dhe shfrytëzimi

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk shfrytëzojnë nxënësit, stafin pedagogjik, drejtuesit e shkollës, supervizorët ose studentët gjatë praktikës mësimore dhe praktikantët gjatë praktikës profesionale, përmes marrëdhënieve profesionale, ose nuk i pranojnë këto veprime nga kolegët e tyre. Ata zbatojnë aktet ligjore në fuqi dhe e referojnë në strukturat përgjegjëse ngacmimin seksual të nxënësve, nëse janë në dijeni apo kanë dyshime të arsyeshme.

Standardi III.4.4 Marrëdhëniet seksuale

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk përfshihen në marrëdhënie seksuale me individë me të cilët kanë autoritet vlerësimi, duke përfshirë nxënësit, drejtuesit e shkollës apo supervizorët. Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk përfshihen në marrëdhënie seksuale me persona që janë duke ofruar shërbim aktual apo të mëparshëm, me prindërit, vëllezërit e motrat ose me anëtarët e tjerë të ngushtë të familjes së nxënësit që po i ofrojnë shërbime. Për shkak se ata kanë detyrim marrjen parasysh të mirëqenies së të gjithë anëtarëve të familjes dhe të ruajnë besimin, punonjësit e shërbimit psiko-social janë të kujdeshëm, në lidhje me marrëdhëniens seksuale me prindërit, me vëllezërit e motrat ose me anëtarët e tjerë të ngushtë të familjes së nxënësit, pas përfundimit të marrëdhënie profesionale.

Parimi i përgjithshëm III.5 Konflikti i interesit

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të drejtpërdrejtë në përshkrimin e çdo konflikti të mundshëm interesit, që mund të ndërhyjë në efektivitetin profesional, pavarësisht nëse këto konflikte janë sisteme besimi financiar apo personal.

Standard III.5.1 Sjellja private kundrejt sjelljes profesionale

Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” ofron standarde për sjelljen profesionale. Punonjësit e shërbimit psiko-social, në jetën e tyre private, janë të lirë të ndjekin interesat e tyre personale, përvçese në atë masë që interesat komprometojnë besimin në profesion ose në efektivitetin profesional.

Standardi III.5.2 Ndarja e besimeve personale

Punonjësit e shërbimit psiko-social janë të vetëdijshëm për vlerat, qëndrimet dhe besimet e tyre dhe se si këto ndikojnë në punën e tyre me nxënësit, me familjet, me stafin e shkollës dhe me komunitetin. Vendimet, rekomandimet dhe aktivitetet profesionale të punonjësve të shërbimit psiko-social shkollor, udhëhiqen nga të dhëna të bazuara nga praktikat më të mira.

Standardi III.5.3 Besimet dhe përvojat personale

Punonjësit e shërbimit psiko-social njojin kur besimet, qëndrimet ose përvojat e tyre përbëjnë pengesë për ofrimin e shërbimeve kompetente, për nxënës ose familje të caktuar. Në situata të tilla, punonjësit e shërbimit psiko-social marrin supervizim, që do t'i lejojë ata të ofrojnë shërbime cilësore, nëse është e mundur. Nëse nuk është e realizueshme, ata kërkojnë rishpërndarjen e çështjes te një punonjës tjetër i shërbimit psiko-social ose e drejtojnë nxënësin në shërbime alternative dhe lehtësojnë kalimin në ato shërbime.

Standardi III.5.4 Referimet dhe shpërblimi

Punonjësit e shërbimit psiko-social as nuk jepin, as nuk marrin ndonjë shpërblim, për referimin e nxënësve për shërbime profesionale.

Standardi III.5.5 Shpërblimi për ndarjen e të dhënavë

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk pranojnë asnjë shpërblim, në këmbim të të dhënavë nga regjistri i të dhënavë të nxënësve të tyre, pa lejen e punëdhënësit të tyre dhe një përcaktimi,

nëse publikimi i të dhënave kërkon etikisht miratimin/pëlqimin e informuar të prindit ose të nxënësve në moshë të rritur.

Standardi III.5.6 Ushtrimi i detyrës në shkollë kundrejt punës private

Punonjësit e shërbimit psiko-social që ofrojnë shërbime në shkollë, të cilët gjithashtu, angazhohen në ofrimin e shërbimeve private (praktikues të dyfishtë), njojin potencialin për konflikt interesi midis dy roleve të tyre dhe ndërmarrin hapa për të shmangur konflikte të tilla.

Praktikuesit e punësimit të dyfishtë:

III.5.6ajanë të detyruar të informojnë prindërit ose nxënësit e tjera potencialë, për çdo shërbim psiko-social dhe arsimor, që është në dispozicion të tyre, pa asnjë kosto nga shkolla, para se të ofrojnë shërbime të tilla me shpërblim;

III.5.6bnuk mund të ofrojnë ose japid shërbime private për një nxënës (ose prindërit e tyre, ose anëtarët e familjes) të shkollës, nëse këto shërbime nuk janë të disponueshme në mjeshterin e shkollës;

III.5.6cnuk mund të ofrojnë ose të sigurojnë vlerësim të pavarur, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore për aftësinë e kufizuar apo arsimin special, për një nxënës shkolle ku profesionistët janë të punësuar;

III.5.6dnuk përdorin teste, materiale, pajisje, asistencë ose shërbime të tjera që i përkasin punëdhënësit të sektorit publik, për qëllime të punës private, përveç kur miratohen paraprakisht nga punëdhënësi;

III.5.6e kryejnë të gjitha punët private jashtë orarit të kontraktuar të punësimit publik, përveç rasteve kur janë thirrur për të dhënë e ekspertizë profesionale.

FUSHA IV: PËRGJEGJËSI NDAJ SHKOLLAVE, FAMILJES, KOMUNITETIT, PROFESIONIT DHE SHOQËRISË

Punonjësit e shërbimit psiko-social promovojnë mjedis të shëndetshëm të shkollës, të familjes dhe të komunitetit. Ata marrin rol proaktiv, në identifikimin e padrejtësive shoqërore që prekin fëmijët, të rinjtë dhe shkollat, si dhe përpiken të korrigojnë modelet e padrejtësisë në nivelin e sistemeve. Punonjësit e shërbimit psiko-social që marrin pjesë në forume diskutimi publik, personalisht dhe me mjete elektronike, u përbahen përgjegjësive etike, në lidhje me respektimin e dinjitetit të të gjithë personave dhe ruajtjen e besimit të publikut në profesion. Punonjësit e shërbimit psiko-social gjithashtu, ruajnë besimin e publikut, duke respektuar ligjet dhe duke inkurajuar sjelljen etike. Punonjësit e shërbimit psiko-social përmirësojnë aspektin profesional, duke mentoruar praktikues me më pak përvojë dhe duke kontribuar në bazën e njojurive shkollore.

Parimi i përgjithshëm IV.1 Promovimi i mjedisit të shëndetshëm të shkollës, të familjes dhe të komunitetit

Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin ekspertizën e tyre në psikologji/punë sociale dhe edukim, për të promovuar mjedise të sigurta dhe të shëndetshme për nxënësit në shkollë, familje dhe komunitet.

Standardi IV.1.1 Pjesëmarrja efektive në sistem

Për të ofruar shërbime efektive dhe konsultime me sistemet, punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njojuri për organizimin, filozofinë, qëllimet, objektivat, kulturën dhe metodologjitet e mjediseve në të cilat ata ofrojnë shërbime. Përveç kësaj, punonjësit e shërbimit psiko-social zhvillojnë partneritete dhe rrjete me ofruesit dhe me agjencitë e shërbimeve të komunitetit, për të ofruar shërbime pa probleme për fëmijët, për të rinjtë dhe për familjet.

Standardi IV.1.2 Promovimi i ndryshimit të sistemeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin ekspertizën e tyre profesionale, për të promovuar ndryshime në shërbimet e komunitetit dhe në shkolla, në mënyrë që të përfitojnë fëmijët, të rinjtë dhe nxënësit e tjerë. Ata advokojnë për politikat dhe praktikat e shkollës, që janë në interesin më të lartë të fëmijëve, si dhe respekojnë dhe mbrojnë të drejtat ligjore të nxënësve dhe të prindërve.

Parimi i përgjithshëm IV.2 Respektimi i ligjit dhe marrëdhënia e ligjit me etikën

Punonjësit e shërbimit psiko-social kanë njojuri dhe respekojnë ligjet që kanë të bëjnë me praktikën e shërbimit psiko-social shkollar. Në zgjedhjen e veprimeve të përshtatshme, ata marrin parasysh marrëdhënien midis ligjit, “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollar” dhe akteve ligjore dhe nën ligjore të urdhreve përkatës.

Standardi IV.2.1 Kuptimi i sistemeve të punës

Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë se vetëdija për politikat, për procedurat dhe për kërkesat ligjore të vendit të tyre të punës, është thelbësore për funksionimin efektiv brenda atyre mjediseve.

Standardi IV.2.2 Kryqëzimi i së drejtës dhe i etikës

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë ligjin dhe të drejtat civile dhe ligjore të nxënësve. Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” mund të kërkojë një standard më të reptë të sjelljes në raport me ligjin, dhe në të tilla situata, punonjësit e shërbimit psiko-social pritet t'u përbahen parimeve.

Standardi IV.2.3 Konfliktet midis ligjit dhe parimeve etike

Kur ndodhin konflikte midis etikës dhe ligjit, punonjësit e shërbimit psiko-social ndërmarrin hapa për të zgjidhur konfliktin, përmes veprimeve të respektuara, pozitive dhe ligjore. Nëse ata nuk janë në gjendje ta zgjidhin konfliktin në këtë mënyrë, ata mund t'i binden ligjit, përderisa veprimet që rezultojnë, nuk shkelin të drejtat themelore të njeriut.

Standardi IV.2.4 Pjesëmarrja në fjalimet publike

Punonjësit e shërbimit psiko-social mund të veprojnë si qytetarë individualë, për të sjellë ndryshime në mënyrë të ligjshme. Kur flasin në fjalime publike, ata identifikohen si qytetarë privatë dhe jo si punonjës dhe, kur flasin si profesionistë, identifikohen si profesionistë individualë, sesa si përfaqësues të një organizimi profesional. Ata gjithashtu, paraqesin në deklarata, besime personale dhe opinione profesionale, të bazuara në të dhëna, në varësi të pozicionit nga i cili po flasin.

Parimi i përgjithshëm IV.3 Ruajtja e besimit publik përmes vetëmonitorimit dhe monitorimit nga kolegët

Punonjësit e shërbimit psiko-social pranojnë përgjegjësinë për monitorimin e sjelljes së tyre dhe sjelljen e punonjësve të tjerë të shërbimit psiko-social të shkollës, për të siguruar përputhjen me standardet etike.

Standardi IV.3.1 Zbatimi i parimeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social konsultohen me “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” dhe i zbatojnë me përgjegjësi, në situata brenda rolit dhe kontekstit të tyre të punësimit. Në situata të vështira, punonjësit e shërbimit psiko-social përdorin një qasje sistematike të zgjidhjes së problemeve në vendimmarrje, duke përfshirë konsultimin me psikologët/punonjësit social me përvojë të shkollave, të njësisë vendore arsimore, të njësisë vendore rajonale etj.

Standardi IV.3.2 Zgjidhja e shqetësimeve me kolegët

Kur një punonjës i shërbimit psiko-social dyshon se një punonjës tjetër i shërbimit psiko-social është angazhuar në praktika joetike, ata përpinqen të zgjidhin problemin e dyshuar, përmes një procesi kolegjal të zgjidhjes së problemeve, nëse është e realizueshme. Nëse një proces kolegjal i zgjidhjes së problemeve, nuk është i mundur ose produktiv, punonjësit e shërbimit psiko-social ndërmarrin veprime të mëtejshme, të përshtatshme për situatën, duke përfshirë diskutimin e situatës me një supervizor, me drejtuesin e njësisë së shërbimit psiko-social në nivel njësie vendore arsimore apo me drejtuesin e njësisë së shërbimit psiko-social në nivel njësie arsimore rajonale. Gjithashtu, punonjësit e shërbimit psiko-social mund t’iu drejtohen edhe urdhrit përkatës të profesionit, për të adresuar problematikat e ndryshme që lindin gjatë ushtrimit të detyrës.

Parimi i përgjithshëmIV.4 Kontributi në profesion duke mentoruar, duke mësuar dhe duke supervizuar

Si pjesë e detyrimit të tyre ndaj nxënësve, shkollave, shoqërisë dhe profesionit të tyre, punonjësit e shërbimit psiko-social mentorojnë praktikuesit me më pak përvojë dhe studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale, për të siguruar shërbime me cilësi të lartë, dhe shërbejnë si modele për praktika dhe vendimmarrje etike dhe profesionale.

Standardi IV.4.1 Supervizimi i studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale

Punonjësit e shërbimit psiko-social, të cilët ofrojnë supervizim të drejtpërdrejtë për punonjësit e shërbimit psiko-social, studentë gjatë praktikës mësimore dhe praktikantët gjatë praktikës profesionale, janë përgjegjës për të gjitha praktikat mësimore dhe profesionale të personave që kanë nën mbikëqyrje. Supervizori siguron që punonjësi i shërbimit psiko-social, studentë gjatë praktikës mësimore dhe praktikantët gjatë praktikës profesionale, të mbikëqyren në mënyrë adekuate. Praktikat e mbikëqyrjes dhe të supervizimit mund të jenë të orientuara nga aktet ligjore dhe nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin apo urdhri përkatës të profesionit të rregulluar ku bën pjesë punonjësi i shërbimit psiko-social.

Standardi IV.4.2 Përgjegjësia e supervizorit

Punonjësit e shërbimit psiko-social, që supervizojnë punën e punonjësve të shërbimit psiko-social, i zbatojnë këto parime etike në punën e tyre të përditshme, me personat të cilët kanë në mbikëqyrje. Ata promovojnë praktikën etike të punonjësve të shërbimit psiko-social dhe studentëve gjatë praktikës mësimore dhe praktikantëve gjatë praktikës profesionale, duke ofruar udhëzime, reagime dhe mentorim specifik dhe gjithëpërfshirës. Përveç kësaj, ata advokojnë për kushte optimale të punës dhe mundësi të vazhdueshme të zhvillimit profesional, për profesionistët që mbikëqyrin.

Parimi i përgjithshëm IV.5 Kontributi në bazën e njohurive të psikologjisë shkollore/punës sociale

Për të përmirësuar shërbimet përfshirë fëmijët, të rinjtë, familjet dhe shkollat dhe përfshirë promovuar mirëqenien e nxënësve, punonjësit e shërbimit psiko-social inkurajohen të kontribuojnë në bazën e njohurive të psikologjisë shkollore dhe të punës sociale, duke marrë pjesë dhe duke ndihmuar në kryerjen dhe shpërndarjen e kërkimeve.

Standardi IV.5.1 Kryerja e kërkimeve

Kur hartojnë dhe kryejnë kërkime në shkolla, punonjësit e shërbimit psiko-social zgjedhin tema dhe përdorin metodologjinë e kërkimit, procedurat e pjesëmarrësve në kërkime, metodat e grumbullimit të të dhënavë dhe teknikat e analizës dhe të raportimit që bazohen në praktikat e duhura të kërkimit. Punonjësit e shërbimit psiko-social deklarojnë nivelin e tyre të përgatitjes dhe të diplomimit pasuniversitar, te pjesëmarrësit e mundshëm të kërkimit.

Standardi IV.5.2 Mbrojtja e të drejtave të pjesëmarrësve në kërkime

Punonjësit e shërbimit psiko-social respektojnë të drejtat dhe mbrojnë mirëqenien e pjesëmarrësve të kërkimit. Punonjësit e shërbimit psiko-social marrin miratimin/pëlqimin e duhur të kërkimit të propozuar, para fillimit të mbledhjes së të dhënavë të tyre.

Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë rreziqet e mundshme (përfshirë rreziqet e dëmtimit fizik ose psikologjik, ndërhyrjet në privatësi, shkeljen e konfidencialitetit) dhe përfitimet e hulumtimit të tyre, si dhe kryejnë vetëm studime ku rreziqet për pjesëmarrësit janë të minimizuara dhe të pranueshme.

Standardi IV.5.3 Anonimiteti i të dhënavë

Punonjësit e shërbimit psiko-social mund të përdorin informacion identifikues të rastit, në leksione, në prezantime ose në publikime, kur është marrë miratimi/pëlqimi me shkrim për ta bërë këtë. Përndryshe, ata heqin dhe maskojnë informacionin identifikues të rastit, kur diskutojnë rastet e vlerësimit, të konsultimit ose të ndërhyrjes.

Standardi IV.5.4 Saktësia e të dhënavë

Punonjësit e shërbimit psiko-social nuk publikojnë ose nuk paraqesin të dhëna, ose rezultate të fabrikuara, ose të falsifikuara, në publikimet, në prezantimet dhe në raportet e tyre profesionale.

Standardi IV.5.5 Përsëritja e të dhënave

Punonjësit e shërbimit psiko-social vënë në dispozicion të dhënat e tyre ose informacione të tjera, të siguruara nga gjetjet dhe nga përfundimet e raportuara në publikime dhe në prezantime, nëse këto të dhëna janë të nevojshme për të adresuar një shqetësim ose nevojë legjitime dhe me kusht që konfidencialiteti dhe të drejtat e tjera të pjesëmarrësve të mbrohen në kërkime.

Standardi IV.5.6 Korrigjimi i gabimeve

Nëse gabimet zbulohen pas publikimit ose pas prezantimit të kërkimit, ose pas informacionit tjetër, punonjësit e shërbimit psiko-social bëjnë përpjekje për të korrigjuar gabimet, duke publikuar gabime, tërheqje ose korrigjime.

Standardi IV.5.7 Integriteti i publikimeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social publikojnë vetëm të dhëna ose informacione të tjera, që japin kontribute originale në literaturën profesionale. Ata nuk raportojnë të njëtin studim në një botim të dytë, pa pranuar publikimin e mëparshëm me të dhëna të njëjtë. Ata nuk kopjojnë pjesë të rëndësishme të publikimeve të mëparshme të tyre dhe/ose të të tjerëve, pa marrë lejen e së drejtës së autorit.

Standardi IV.5.8 Plagjiatura

Kur publikojnë ose prezantojnë kërkime ose punë të tjera, punonjësit e shërbimit psiko-social nuk publikojnë veprat ose idetë e të tjerëve, si vepra ose ide të tyre (plagjiaturë). Ata citojnë dhe referojnë në mënyrë të përshtatshme të gjitha burimet, të shtypura ose digitale, dhe u japin merita atyre, idetë e të cilëve janë pasqyruar. Në prezantimet e shërbimit ose konferencës, punonjësit e shërbimit psiko-social u njohin merita të tjerëve, idetë e të cilëve janë përdorur ose janë përshtatur.

Standardi IV.5.9 E drejta e autorit

Punonjësit e shërbimit psiko-social pasqyrojnë me saktësi, kontributet e autorëve dhe të individëve të tjerë në prezantime dhe në botime. Merita e autorit i jepet vetëm individëve që

kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm profesional, në kërkimin, në publikimin ose në prezantimin. Autorët diskutojnë dhe zgjidhin çështje që lidhen me meritat e publikimit, sa më shpejt të jetë e mundur, në procesin e kërkimit dhe të publikimit.

Standardi IV.5.10 Rishikimi i dorëshkrimeve dhe i propozimeve

Punonjësit e shërbimit psiko-social, që marrin pjesë në rishikimet e dorëshkrimeve, të propozimeve dhe të materialeve të tjera, respektojnë konfidentialitetin dhe të drejtat pronësore të autorëve (pronësia intelektuale). Ata e kufizojnë përdorimin e materialeve të tyre në aktivitetet përkatëse, për qëllimet e rishikimit profesional. Punonjësit e shërbimit psiko-social, që rishikojnë materialet profesionale, nuk komunikojnë identitetin e autorit, nuk citojnë/kopjojnë nga materialet ose nuk qarkullojnë kopje të materialeve, pa lejen e autorit.

BIBLIOGRAFIA

Australian Psychological Society. (2016). The frameëork for effective delivery of school psychology services: a practice guide for psychologists and school leaders. APS.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (2020). Rregullore “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Tiranë.

National Association of School Psychologists. (2020). Model for Comprehensive and Integrated School Psychological Services. NASP.

Udhëzimi nr. 4, datë 11.4.2016 “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”.

Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”.

Urdhri nr. 31, i MASR-së, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregulloreve për funksionimin e institacioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

SHTOJCA



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX
ZYRA VENDORE ARSIMORE XXXX
SHKOLLA “_____”

(Shtojca 1)

MIRATIMI/PËLQIMI I INFORMUAR

(Në nivel individual)

Bazuar në Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë miratuar me urdhër Nr. 31, Dt. 28/01/2020, Neni 29, Kreu VIII , neni 32, pika 2 dhe Parimeve për Etikën Profesional të Shërbimit Psiko-social Shkollor, punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore krahas ndërhyrjeve në grup me nxënësit, i lind nevoja dhe përgjegjësia ligjore për kontakte individuale dhe të drejtpërdrejta me nxënësit, brenda institucionit arsimor që ai mbulon.

Për arsyet e mësipërme, kërkojmë nga ju si prind/kujdestar ligjor i fëmijës të plotësoni formularin e mëposhtëm:

Unë _____, prind/kujdestar ligjor
(emri mbiemri i prindit/ kujdestarit ligjor)

i fëmijës _____, i datëlindjes ____ / ____ / ____,
(emri mbiemri i fëmijës) (dd/ mm/ vvvv)

deklaroj se punonjësi i shërbimit psiko-social:

- Ka miratim/pëlqimin tim** për kontakte, këshillime dhe vlerësime individuale, nëse paraqitet nevoja gjatë qëndrimit të nxënësit në Institucionin Arsimor.
- Nuk ka miratimin tim.

Prindi/ kujdestari ligjor _____
(emri mbiemri i prindit/ kujdestarit ligjor, firma)

Tiranë, më ____ / ____ / ____



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR XXXX
ZYRA VENDORE ARSIMORE XXXX
SHKOLLA “_____”

(Shtojca 2) MIRATIMI/PËLQIMI I INFORMUAR

(Në nivel grupi/klase)¹

Bazuar në Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë miratuar me urdhër Nr. 31, Dt. 28/01/2020, Neni 29, Kreu VIII , neni 32, pika 2 dhe Parimeve për Etikën Profesional të Shërbimit Psiko-social Shkollor, punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore krahas ndërhyrjeve individuale me nxënësit, i lind nevoja dhe përgjegjësia ligjore për kontakte në nivel grupi/klase dhe të drejtpërdrejta me nxënësit, brenda institucionit arsimor që ai mbulon.

Për arsyet e mësipërme, kërkojmë nga ju si prind/kujdestar ligjor të fëmijëve të klasës XX të plotësoni formularin e mëposhtëm:

Nr.	Emër Mbiemër (i prindit)	Emri fëmijës (i nxënësit)	Miratimi/Pëlqimi Po/Jo	Firma
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
...				

Tiranë, më _____ / _____ / _____

¹Miratimi/pëlqimi informuar në nivel grupi/klase kërcohët në fillim të vitit shkollor.

PARIMET PËR ETIKËN PROFESIONALE TË SHËRBIMIN PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR

(Shtojca 3)

REGJISTRI I TË DHËNAVE

Nr. Regj.	Kodi i dosjes (nëse ka)	Data	Referuesi	Shqetësimi parësor	Emër mbienër	Gjimia F/M	Datëlindja	Përfitesi i shërbimit (nxënës/prind/ mësues)	Klasa (nëse nxënësi)	SHPS përgjegjës	Shënime



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruja "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tirana

Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441